



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr.22

2005

13 prill

P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Ligj nr.9355 datë 10.3.2005	Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore..... 829
Vendim i Kuvendit nr.179, datë 15.3.2005	Për ngritjen e Komisionit të Posaçëm të Kuvendit për Zbatimin e Legjislacionit të Zgjedhjeve..... 840
Vendim i Kuvendit nr.180, datë 23.3.2005	Për miratimin e Raportit Përfundimtar dhe konkluzioneve të Komisionit Hetimor Parlamentar për Prokurimet Publike të Kryeministrit dhe Ministrive..... 840
Vendim i Kuvendit nr.181, datë 24.3.2005	Për përbërjen e Komisionit të Posaçëm Parlamentar “Për zbatimin e legjislacionit të zgjedhjeve” ngritur me vendimin nr.179, datë 15.3.2005..... 841
Dekret nr.4529 datë 8.4.2005	Për lejim lënie të shtetësisë shqiptare..... 842
	Rezolutë e Kuvendit për vlerësimin e veprimtarisë së institucionit të Kontrollit të Lartë të Shtetit për vitin 2004..... 843
Urdhër i MF nr.11, datë 25.3.2005	Rezolutë e Kuvendit për gjendjen në shërbimin civil..... 843 Për miratimin e primit të sigurimit të detyrueshëm të mbajtësve të mjeteve motorike për përgjegjësinë ndaj palëve

	të treta.....	845
Vendim i Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut	Lidhur me pranueshmërinë e Aplikimit nr.10513/03 nga Stefan Naumov kundër Shqipërisë.....	849
Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr.28, datë 30.3.2005	Për miratimin e rregullores “Për mbikëqyrjen e transaksioneve bankare në rrugë elektronike”.....	854
Vendim i KKRT nr.327, datë 29.3.2005	Mbi licencën për TV vendor privat “Skampa”.....	862
Vendim i KKRT nr.328, datë 29.3.2005	Për dhënie licence për ritransmetim të programeve të huaja radio në Shqipëri “RFI”.....	863
Vendim i KKRT nr.329, datë 29.3.2005	Për rinovimin e licencës së subjektit televiziv vendor “TV Kukësi”.....	863
Vendim i KKRT nr.330, datë 29.3.2005	Për rinovimin e licencës së subjektit televiziv vendor “TV ATN 1”.....	864
	Shpallje kërkesë për shpronësim me interes publik të pasurisë së paluajtshme të tipit “tokë bujqësore arë”, që preket nga ndërtimi i nënstacionit 110/120 Porto-Romano, Durrës.....	864

LIGJ
Nr.9355, datë 10.3.2005

PËR NDIHMËN DHE SHËRBIMET SHOQËRORE

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Ky ligj ka për qëllim:

1. Të përcaktojë ndihmën dhe shërbimet shoqërore për individët dhe grupet në nevojë, të cilët nuk mund të sigurojnë plotësimin e nevojave bazë jetike, zhvillimin e aftësive dhe të mundësive personale dhe ruajtjen e integritetit për shkak të aftësive dhe mundësive të kufizuara ekonomike, fizike, psikologjike e shoqërore.
2. Të zbusë varfërinë dhe përjashtimin shoqëror për individët dhe familjet, si dhe të krijojë mundësi për integrimin e tyre, nëpërmjet sigurimit të një sistemi ndërhyrjesh e shërbimesh për përmirësimin e jetesës së tyre.

Neni 2

Ky ligj rregullon marrëdhëniet e financimit e të ofrimit të ndihmës dhe shërbimeve shoqërore në Shqipëri.

Neni 3

Parimet bazë, mbi të cilat funksionon skema e ndihmës dhe e shërbimeve shoqërore, janë:

- a) respekti dhe garantimi i vlerave dhe i personalitetit të individit;
- b) universaliteti;
- c) barazia e mundësive;
- ç) e drejta për të përfituar;
- d) partneriteti;
- dh) transparenca dhe paanshmëria;
- e) decentralizimi;
- ë) pavarësia, integrimi shoqëror dhe pjesëmarrja në jetën e komunitetit;
- f) mosdiskriminimi;
- g) karakteri subvencionues;

Neni 4

Në kuptim të këtij ligji:

1. “Ndihmë ekonomike” është mbështetja, në para e natyrë, e individëve me status të veçantë dhe e familjeve në nevojë.
2. “Pagesë për personat me aftësi të kufizuar” është pagesa mujore, në lekë, që u jepet personave me aftësi të kufizuar, sipas përcaktimit të këtij ligji.
3. “Person me aftësi të kufizuar” është individ, të cilit i është kufizuar aftësia, si pasojë e dëmtimit fizik, shqisor, të intelektit, psikiko-mendor, të lindura apo të fituara gjatë jetës nga aksidente,

sëmundje të përkohshme ose të përhershme, të cilat nuk vijnë nga shkaqe që lidhen me punësimin.

4. “Invalid pune” është individ i cili është deklaruar i tillë me vendim të Komisionit Mjekësor të Kaktimit të Aftësisë për Punë, që përfiton nga ligji nr. 7889, datë 14. 12. 1994 “Për statusin e invalidëve”, i ndryshuar.

5. “Shërbime shoqërore” është tërësia e shërbimeve që u ofrohet individëve dhe grupeve në nevojë, të cilët nuk janë në gjendje të përballojnë, me burimet që kanë, nevojat e tyre jetësore për ruajtjen, zhvillimin dhe rehabilitimin e mundësive individuale, për të kapërcyer nevojat emergjente ose kronike.

6. “Njësi e pushtetit vendor” është bashkia ose komuna, ku subjektet përfituese, sipas këtij ligji, ushtrojnë të drejtën për të kërkuar kompensimin e të ardhurave materiale ose/dhe monetare, të cilat u mungojnë plotësisht ose pjesërisht, si dhe për shërbime shoqërore.

7. “Administrator shoqëror” është nëpunësi civil i organeve të pushtetit vendor, i cili administron shpërndarjen e ndihmës ekonomike dhe ofrimin e shërbimeve shoqërore për individët në nevojë.

8. “Familje” është një grup individësh, që lidhen në marrëdhënie bashkëshortore, si dhe marrëdhëniet prindër-fëmijë, marrëdhëniet ndërmjet anëtarëve të familjes dhe ato të kujdestarisë, që jetojnë në të njëjtën strehë.

9. “Familje kujdestare” është një familje alternative, sipas përkufizimit të dhënë në nenin 266 të ligjit nr. 9062, datë 8. 5. 2003 “Kodi i Familjes”.

10. “Kryetar i familjes” është personi, sipas kësaj renditjeje: babai, nëna, anëtari më i madh i familjes, në grup-moshën aktive 18-65 vjeç, anëtari më i ri i familjes, në grup-moshën mbi 65 vjeç, dhe kujdestari, kur të gjithë anëtarët e familjes janë nën moshën 18 vjeç.

11. “Familje në nevojë” është familja, që nuk ka të ardhura materiale ose/dhe monetare apo i ka të pamjaftueshme, nga veprimtaria ekonomike, programe të tjera të mbrojtjes shoqërore dhe kapitali.

12. “Familje bujqësore” është familja, që ka në pronësi tokë të punueshme, pavarësisht nga vendndodhja e familjes ose e tokës.

13. “Të ardhura të familjes” janë të ardhurat e të gjithë anëtarëve të familjes nga çdo lloj burimi, duke përfshirë dhe ata që përkohësisht jetojnë dhe punojnë jashtë shtetit. Nuk përfshihen në të ardhurat e familjes pagesat që marrin pjesëtarët e familjes me aftësi të kufizuar mendore ose fizike, të verbërit, paraplegjikët e tetraplegjikët, përfitimet e invalidëve sipas Statusit të Invalidit të Punës, si dhe pagesat për fëmijët e lindur si trinjakë a më shumë.

14. “Jetim” është fëmija pa prindër, deri në moshën 25 vjeç, sipas përcaktimit të bërë në ligjin nr. 8153, datë 31.10.1996 “Për statusin e jetimit”.

15. “Shërbime shoqërore në komunitet” janë të gjitha llojet e shërbimeve shoqërore, publike dhe jopublike, që kryhen në nivel vendor në territorin nën juridiksionin e bashkisë ose komunës.

16. “Person i moshuar” është personi, që ka arritur moshën e pensionit të pleqërisë, sipas legjislacionit në fuqi.

17. “Vendbanim” është vendi ku familja ose personi, për shkak të punës apo të shërbimit të përhershëm, të ndodhjes së pasurisë ose të realizimit të interesave të vet, qëndron zakonisht ose të shumtën e kohës.

18. “Vendqëndrim” është vendi ku banohet për një kohë të caktuar për arsye pune, studimi, trajtimi mjekësor, pushimi, shërbimi të detyruar ushtarak apo vuajtjeje dënimi, si dhe raste të tjera të kësaj natyre.

19. “Burime jetese” janë të gjitha mjetet monetare ose të ardhurat në natyrë, të cilat bëjnë të mundur jetesën.

20. “Veprimtari ekonomike” është çdo veprimtari, në formën e punësimit, të vetëpunësimit, të punës që kryhet pa pagesë pranë një anëtari të vetëpunësuar të familjes, si dhe çdo veprimtari tjetër e ngjashme, që sjell të ardhura për individët dhe familjet e tyre.

21. “Kapital” është çdo lloj prone ose pasurie që mund të sjellë të ardhura.

22. “Veprim i qëllimshëm” është çdo veprim që synon të shmangë punësimin e shpërblyer, kualifikimin për punësim dhe për mundësi punësimi, trajtimin mjekësor në rastet e përdoruesit të drogës ose të përdoruesit me tepri të alkoolit, mospërdorimin e kapitalit atje ku është mundësia për të siguruar mjetet e domosdoshme të jetesës, dhënies reale të të ardhurave, si dhe çdo veprim që nxit ndarjen e familjeve, që vërtetohet se kanë të njëjtën strehë, për përfitim nga ndihma ekonomike.

KREU II PËRFITUESIT E NDIHMËS DHE TË SHËRBIMIT SHOQËROR

Neni 5

Përfitues të ndihmës ekonomike janë:

1. Familjet në nevojë.
2. Jetimët mbi 25 vjeç, të papunë, të cilët nuk janë në institucione ose nën kujdestari.
3. Prindërit me më shumë se 2 fëmijë të lindur njëherësh, që u përkasin familjeve në nevojë.

Neni 6

Përfituesit e shërbimeve shoqërore janë fëmijët, të rinjtë deri në moshën 25 vjeç, të moshuarit, personat me aftësi të kufizuar, gratë, vajzat në nevojë, si dhe të gjithë ata që janë në rrezik të bëjnë pjesë në grupet në nevojë.

Neni 7

Përfitues të pagesës për aftësinë e kufizuar janë:

1. Të verbrit, me mungesë të plotë ose të pjesshme të shikimit, të lindur ose të fituar, të cilët janë deklaruar të paaftë për punë me vendim të Komisionit Mjekësor të Përcaktimit të Verbërisë.
2. Paraplegjikët dhe tetraplegjikët, të cilët deklarohen me vendim të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë se janë bërë të tillë, pavarësisht nga shkaku dhe moshja.
3. Personat me aftësi të kufizuar, të cilët deklarohen të paaftë për punë me vendim të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë.
4. Personat, të cilët janë deklaruar invalidë pune me vendim të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë, që përfitojnë pension invaliditeti dhe shtesë mujore mbi të, sipas Statusit të Invalidit të Punës.

Neni 8

Personat përfitues që përcaktohen në pikat 1, 2, 3 të nenit 7 të këtij ligji, të cilët me vendim të komisioneve mjekësore të posaçme përcaktohen se kanë nevojë për përkujdesje, përfitojnë edhe një kujdestar me pagesë.

Neni 9

Nga ky ligj nuk përfitojnë:

1. Shtetasit shqiptarë që banojnë jashtë vendit si emigrantë, me përjashtim të personave dhe të familjeve të tyre të caktuar me punë pranë përfaqësive tona diplomatike dhe organizmave ndërkombëtarë.
2. Azilkërkuesit, të cilët nuk kanë marrë statusin e azilit.
3. Shtetasit shqiptarë, shtetasit e huaj ose personat pa shtetësi, të cilët kanë nevojë për ndihmë emergjente, si pasojë e fatkeqësive natyrore dhe e luftërave.

KREU III LLOJET E PËRFITIMIT TË NDIHMËS EKONOMIKE DHE TË SHËRBIMEVE SHOQËRORE

Neni 10

Ndihma ekonomike jepet në formën e një kësti mujor, në lekë, ose përfitimi mujor, në natyrë,

për kategoritë e përcaktuara në nenin 5 të këtij ligji.

Masa mujore e ndihmës ekonomike në vlerë përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 11

1. Pagesa për personat me aftësi të kufizuar jepet në formën e një kësti mujor, në lekë. Masa e pagesës për këta individë dhe për kujdestarët e tyre përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

2. Përfituesit e përcaktuar në nenin 7 të këtij ligji, të klasifikuar me vendim të komisioneve mjekësore të aftësisë në grupet e dyta të paaftësisë, humbasin të drejtën e pagesës së aftësisë së kufizuar në çastin e punësimit të tyre.

Neni 12

Shërbimet shoqërore, sipas natyrës, ndahen në:

- a) shërbime të përkujdesit shoqëror;
- b) shërbime të përkujdesit shoqëror-mjekësor.

Neni 13

1. Shërbimet e përkujdesit shoqëror përfshijnë shërbimet që u ofrohen individëve, familjeve, grupeve në nevojë, komuniteteve, të përcaktuara në nenin 6 të këtij ligji, për plotësimin e nevojave të tyre jetësore.

2. Shërbimet e përkujdesit shoqëror-mjekësor ofrohen nga personeli i specializuar në qendra riintegruese dhe rehabilituese rezidenciale, në qendra ditore ose në familje, për individët, të cilët nuk janë në gjendje të jetojnë normalisht, për shkak të përkeqësimeve të përkohshme apo të përhershme fizike, psikike dhe mendore.

Neni 14

Shërbimet e përkujdesit shoqëror, sipas mënyrës së organizimit dhe të funksionimit, janë:

- a) shërbime të përkujdesit rezidencial;
- b) shërbime të përkujdesit komunitar.

Neni 15

1. Shërbimi në institucionet rezidenciale ofrohet për individë, për të cilët përkujdesi në shtëpi nuk është i mundur. Vendosja e tyre në qendrat e përkujdesit shoqëror bëhet me pëlqimin e personit, pas vlerësimit të gjendjes shoqërore, ekonomike dhe mjekësore të tij.

2. Shërbimet e përkujdesit komunitar ofrohen në qendra ditore, në shtëpitë e individëve ose në familjen kujdestare, sipas nevojave specifike të grupeve përfituese.

Neni 16

Shërbimet e përkujdesit shoqëror, sipas mënyrës së financimit, klasifikohen në shërbime publike dhe në shërbime private.

Neni 17

1. Shërbimet e përkujdesit shoqëror publik përfshijnë shërbimet e përkujdesit shoqëror, që ofrohen në institucionet rezidenciale, ditore ose në shtëpi, për grupet në nevojë.

Këto shërbime financohen nga buxheti qendror dhe nga buxhetet e pavarura të organeve të qeverisjes vendore.

Bashkitë ose komunat administrojnë të gjitha shërbimet shoqërore për individë, që janë banorë të atij qyteti apo komune.

Qarku administron shërbime kur ato ofrohen për individë, që u përkasin disa njësive vendore në atë qark.

2. Shërbimet e përkujdesit shoqëror privat përfshijnë shërbimet e përkujdesit shoqëror, që ofrohen në qendrat rezidenciale, në qendrat ditore ose në shtëpi, të financuara privatisht.

Neni 18

1. Personat juridikë publikë dhe personat juridikë privatë, që ofrojnë shërbime të përkujdesit shoqëror, licencohen nga Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale.

Kriteret dhe procedurat për licencimin e tyre përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

2. Shërbimet e përkujdesit shoqëror publik, që financohen me fondet e buxhetit qendror apo vendor prokurohen nga organet e pushtetit vendor tek ofruesit privatë të tyre, sipas legjislacionit në fuqi për prokurimin publik.

3. Organet e pushtetit vendor lidhin kontratë me personat juridikë privatë fitues, për shërbimet që ato ofrojnë në juridiksionin e territorit të tyre.

4. Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale harton standardet e shërbimeve të përkujdesit shoqëror dhe kontrollon zbatimin e tyre. Standardet e shërbimeve të përkujdesit shoqëror miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

KREU IV

KRITERET E PËRFITIMIT DHE PROCEDURA E DHËNIES SË NDIHMËS EKONOMIKE DHE TË OFRIMIT TË SHËRBIMEVE SHOQËRORE

Neni 19

Ndihma ekonomike, që përfitojnë familjet në nevojë, është e plotë ose e pjesshme.

1. Ndihmë ekonomike të plotë përfitojnë familjet ose individët, që nuk kanë të ardhura nga:

a) veprimtaria ekonomike;
b) programet e ndihmës dhe të shërbimeve shoqërore ose ndonjë sistem tjetër i mbrojtjes shoqërore;

c) kapitali;

ç) pjesëtarët e familjes që janë në emigracion.

2. Ndihma ekonomike është e pjesshme kur familja pretenduese ka të ardhura të pamjaftueshme nga:

a) toka;

b) bagëtia, shpendët, bletët, vreshtaria e kopshtaria;

c) pensionet dhe të ardhura të tjera.

3. Vlerësimi në koeficient i të ardhurave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 2 të këtij neni, për efekt të llogaritjes së ndihmës ekonomike të plotë ose të pjesshme, përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 20

1. Ndihma ekonomike dhe pagesa e personave me aftësi të kufizuar shpërndahen një herë në muaj me vendim të këshillit të njësisë së qeverisjes vendore.

2. Kërkesa për të përfituar ndihmë ekonomike bëhet me shkrim nga kryetari i familjes dhe nënshkruhet nga të gjithë anëtarët madhorë të saj. Aplikuesit paraqesin dokumentacionin e nevojshëm tek administratori shoqëror pranë njësisë së pushtetit vendor. Kriteret dhe procedurat për përfitimin e ndihmës ekonomike përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

3. Kërkesa dhe dokumentacioni për të përfituar pagesë për personat me aftësi të kufizuar paraqiten tek administratori shoqëror në njësitë e qeverisjes vendore. Kriteret për përfitimin e pagesës

për personat me aftësi të kufizuar përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

4. Kërkesa dhe dokumentacioni për të përfutur shërbime të përkujdesit shoqëror paraqiten tek administratori shoqëror në njësitë e qeverisjes vendore. Kriteret e pranimit në institucionet e përkujdesit shoqëror dhe për shërbimet në komunitet përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 21

Këshilli i bashkisë ose komunës ka të drejtë të miratojë kritere specifike për të dhënë ndihmë ekonomike ose për të ofruar shërbime të përkujdesit, me fondet e buxhetit vendor, për familjet me shumë pjesëtarë apo familjet në nevojë.

Neni 22

Personat, që kanë nevojë për shërbime të përkujdesit shoqëror, pranohen në institucionet rezidenciale publike pa pagesë, nëse familjet e tyre nuk kanë asnjë të ardhur. Shpenzimet e tyre mbulohen nga Buxheti i Shtetit.

Neni 23

1. Personat, që kanë nevojë për shërbime të përkujdesit shoqëror dhe kanë të ardhura personale, pranohen në institucionet publike të përkujdesit, kundrejt një pagese në raport me të ardhurat e tyre mujore ose të ardhurat e individëve të tjerë përgjegjës. Masa e kontributit përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

2. Pagesa e personave me aftësi të kufizuar, sipas nenit 7 të këtij ligji, nuk përfshihet në llogaritjen e të ardhurave personale të personave, që vendosen në institucionet publike të përkujdesit shoqëror.

3. Përfutuesve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror, që vendosen në institucionet e përkujdesit, u jepet në dorë një shumë në lekë për shpenzime personale. Kjo shumë përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 24

Nivelet e kuotave të shpenzimeve të përkujdesit shoqëror në institucionet publike rezidenciale dhe komunitare miratohen nga Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale. Nivelet e kuotave të shpenzimeve në institucionet private nuk mund të jenë më të ulëta se ato në institucionet publike.

Neni 25

Aplikuesi, të cilit i refuzohet kërkesa për përfutim të ndihmës ekonomike, pagesës për aftësinë e kufizuar ose të shërbimit shoqëror me vendim të këshillit të njësisë së qeverisjes vendore, ka të drejtë për ankimim në gjykatë.

KREU V

DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I SKEMËS SË NDIHMËS DHE SHËRBIMEVE SHOQËRORE

Neni 26

1. Shërbimi Social Shtetëror është institucion publik, në varësi të Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale.

2. Statuti i Shërbimit Social Shtetëror miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

3. Shërbimi Social Shtetëror administrohet dhe drejtohet nga Këshilli Administrativ, i cili është organi më i lartë vendimmarrës.

4. Funkcionet dhe anëtarësia e Këshillit Administrativ përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

5. Shërbimi Social Shtetëror përgjigjet për zbatimin e politikave të Ministrisë së Punës dhe

Çështjeve Sociale në fushën e ndihmës dhe të shërbimeve të përkujdesit shoqëror për:

- a) programimin dhe kontrollin e përdorimit të fondeve të Buxhetit të Shtetit për ndihmën ekonomike, pagesën e personave me aftësi të kufizuar dhe shërbimet e përkujdesit shoqëror;
- b) hartimin e standardeve të shërbimeve dhe propozimin për miratim të shërbimeve të reja;
- c) përcaktimin e dokumentacionit unik të nevojshëm për aplikuesit dhe përfituesit e shërbimeve shoqërore, sipas këtij ligji.

Neni 27

1. Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale është autoriteti përgjegjës për hartimin e politikave, të legjislacionit, programimin e fondeve të ndihmës ekonomike, pagesës për personat me aftësi të kufizuar dhe të shërbimeve shoqërore, normave dhe standardeve të shërbimeve, si dhe kontrollin e zbatimit të tyre në të gjitha nivelet e strukturave qendrore dhe vendore, në sektorin publik dhe privat.

2. Ministri i Punës dhe Çështjeve Sociale ngre Inspektoratin e Ndhmës Ekonomike, Pagesës për Personat me Aftësi të Kufizuar dhe Shërbimeve Shoqërore, i cili kontrollon veprimtarinë dhe zbatimin e legjislacionit në strukturat dhe institucionet në varësi të tij dhe seksionet e ndihmës ekonomike në bashki ose komuna, si dhe miraton dokumentacionin e përcaktuar në nenin 26 pika 5 shkronja “c” të këtij ligji.

3. Procedura e kryerjes së kontrollit nga ky Inspektorat përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

4. Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale grumbullon informacione, statistika dhe raporte nga njësitë e pushtetit vendor, me qëllim vlerësimin dhe monitorimin e zbatimit të politikave, arritjen e standardeve për ndihmën ekonomike, kryerjen e pagesës për personat me aftësi të kufizuar dhe shërbimet e përkujdesit shoqëror. Përmbajtja, periodiciteti dhe treguesit statistikorë përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 28

Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale harton dhe paraqet pranë Ministrisë së Financave nevojat për fonde nga buxheti për ndihmën ekonomike, pagesën për personat me aftësi të kufizuar dhe për shërbimet e përkujdesit shoqëror.

Neni 29

Këshilli i bashkisë ose komunës ka këto përgjegjësi:

1. Miraton fondin dhe numrin e familjeve në skemën e ndihmës ekonomike.
2. Miraton fondin për pagesën e personave me aftësi të kufizuar.
3. Miraton fondin për shërbimet e përkujdesit shoqëror.
4. Harton planin për zhvillimin e shërbimeve të përkujdesit shoqëror, bazuar në burimet, nevojat dhe përparësitë vendore.
5. Miraton dhe mbështet zhvillimin e shërbimeve të përkujdesit në bazë të vlerësimit të nevojave e përparësive vendore.
6. Merr vendime për personat, familjet, llojet e shërbimeve shoqërore që do të ofrohen bazuar në:

- a) vlerësimin e nevojave të individëve dhe familjeve, të kryera nga administratori shoqëror;
- b) mundësitë financiare për ofrimin e këtyre shërbimeve.

7. Vendosi, në përputhje me legjislacionin në fuqi, të drejtën dhe masën e përfitimit të ndihmës ekonomike për familjen, si dhe ofrimin e përfitimeve të veçanta, të parashikuara me ligj.

8. Autorizon strukturat e njësisë së qeverisjes vendore të kontraktjnë me ofrues shërbimesh shoqërore private të licencuara edhe në rastet kur këto shërbime ofrohen nga shërbime shoqërore publike.

9. Me fondet e veta, në bazë të kriterëve specifike, mbështet me ndihmë ekonomike ose forma të tjera ndihme të menjëhershme familjet në nevojë.

10. Miraton programet për kushtëzimin e ndihmës ekonomike me punë e shërbime në komunitet. Kriteret për kushtëzimin e ndihmës me punë e shërbime në komunitet përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

11. Miraton strukturat e institucioneve në varësi të tij, që merren me shpërndarjen e ndihmës ekonomike, pagesës për personat me aftësi të kufizuar dhe realizimin e shërbimeve të përkujdesit nën juridiksionin e tij.

12. Miraton programe bashkëpunimi me OJF-të, institucionet e kultit dhe përfaqësuesit e shoqërisë civile, në përputhje me nevojat dhe planet kombëtare e rajonale të ndihmës dhe shërbimeve të përkujdesit shoqëror.

Neni 30

Për administrimin e skemës së ndihmës dhe të shërbimeve shoqërore, pranë qarqeve, bashkive ose komunave ngrihen strukturat përkatëse. Detyrat dhe përgjegjësitë e këtyre strukturave, në zbatim të këtij ligji, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 31

Administratorët shoqërorë në bashki ose komuna kanë për detyrë:

a) të identifikojnë familjet që kanë nevojë për ndihmë ekonomike, personat me aftësi të kufizuar dhe nevojat e individëve për shërbime të përkujdesit shoqëror;

b) të verifikojnë gjendjen shoqërore e ekonomike të familjeve në nevojë, kur futen për herë të parë në skemë, si dhe dy herë në vit të gjitha familjet që përfitojnë ndihmë ekonomike;

c) të propozojnë në këshillin e bashkisë ose komunës familjet në nevojë, për të përfituar ndihmë ekonomike;

ç) të ndihmojnë në përgatitjen e dokumentacionit për personat që aplikojnë për përfitimin e ndihmës ekonomike, pagesës së aftësisë së kufizuar dhe për shërbimet e përkujdesit shoqëror;

d) të marrin pjesë në procesin e hartimit të projektvendimit për familjet që do të trajtohen me ndihmë ekonomike, të listës së personave me aftësi të kufizuar dhe personave që do të trajtohen me shërbime të përkujdesit shoqëror;

dh) të llogarisin dhe të propozojnë për miratim në seksionin e ndihmës dhe të shërbimeve të përkujdesit shoqëror të bashkisë ose komunës masën e ndihmës ekonomike;

e) të hartojnë kërkesën për bllok-ndihmën dhe fondin e pagesës së personave me aftësi të kufizuar çdo dymujor për njësinë e qeverisjes vendore;

ë) të bashkëpunojnë për hartimin e planeve vendore dhe rajonale në mbështetje të personave në nevojë;

f) të vlerësojnë nevojat e individëve ose familjeve që kërkojnë të marrin shërbime shoqërore, në përputhje me përparësitë kombëtare dhe vendore, mundësitë financiare për mbulimin e këtyre shërbimeve, të përgatisin dokumentacionin dhe propozimet për miratim në këshillin e bashkisë ose komunës;

g) të grumbullojnë dhe të hartojnë informacione, statistika dhe të mbajnë regjistrin e përfituesve, të ndjekin shpenzimet për ndihmën ekonomike, pagesën e personave me aftësi të kufizuar dhe të personave që kanë nevojë për shërbime të përkujdesit shoqëror;

gj) të grumbullojnë informacione për rrjetet e shërbimeve publike dhe private që veprojnë në territorin e bashkisë ose komunës.

KREU VI

FINANCIMI I NDIHMËS DHE SHËRBIMEVE TË PËRKUJDESIT SHOQËROR

Neni 32

Shteti ofron shërbime të përkujdesit shoqëror dhe forma të tjera të mbështetjes për personat në nevojë, sipas mundësive të Buxhetit të Shtetit.

Neni 33

Financimi i programeve të ndihmës ekonomike, pagesës për personat me aftësi të kufizuar dhe shërbimeve shoqërore përballohet nga Buxheti i Shtetit dhe buxhetet e qeverisjes vendore.

Neni 34

Burimet e financimit të ndihmës dhe pagesës së personave me aftësi të kufizuar përbëhen nga:

- a) fondet e Buxhetit qendror të Shtetit;
- b) fondet nga taksat dhe tarifatat vendore.

Neni 35

Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale programon fondet për bllok-ndihmën ekonomike dhe pagesën e personave me aftësi të kufizuar, në përputhje me vlerësimin e kërkesave të ardhura nga njësitë e qeverisjes vendore dhe një herë në dy muaj i transferon ato në bashki ose komunë.

Kriteret dhe treguesit që përdoren për programimin e bllok-ndihmës propozohen nga Ministri i Punës dhe Çështjeve Sociale dhe miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 36

Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale delegon një herë në 4 muaj fondin e bllok-ndihmës ekonomike në bashki ose komuna, të cilat dhënie e ndihmës ekonomike e kushtëzojnë me punë e shërbime të përkujdesit shoqëror në komunitet.

Teprica e fondeve të ndihmës ekonomike, e krijuar si rezultat i menaxhimit më të mirë të bllok-ndihmës, pas miratimit nga Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale, i mbetet njësite vendore. Këto fonde shërbejnë për të mbështetur programe, që zbatohen për punë ose shërbime në komunitet brenda vitit.

Neni 37

Burimet e financimit për shërbimet e përkujdesit shoqëror, që realizohen nga institucionet publike dhe jopublike në nivel qarku, bashkie ose komune, në institucionet rezidenciale, në qendrat ditore, në familje ose shërbime të lëvizshme në komunitet përbëhen nga:

- a) fondet e deleguara nga Buxheti qendror i Shtetit;
- b) fondet e caktuara nga taksat dhe tarifatat vendore;
- c) të ardhurat e caktuara nga pasuritë dhe veprimtari të tjera të bashkisë ose komunës;
- ç) kontributet e përfituesve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror, të përcaktuara në nenin 23 të këtij ligji;

d) dhurimet, sponsorizimet dhe financime të tjera nga organizata, persona fizikë ose juridikë apo individë të tjerë, që nuk përfshihen në shkronjat “a”, “b”, “c” dhe “ç” të këtij neni.

Neni 38

Fondet nga Buxheti Qendror për financimin e shërbimeve të përkujdesit shoqëror delegohen nga Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale në bashki, komunë ose qark që në fillim të vitit, në përputhje me vlerësimin e nevojave dhe me mundësitë e Buxhetit të Shtetit. Metodologjia e llogaritjes dhe e shpërndarjes së këtyre fondeve përcaktohet nga Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 39

Për mbështetjen e shërbimeve të reja të përkujdesit shoqëror dhe zhvillimin e politikave sociale, Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale krijon Fondin Shoqëror, i cili përbëhet nga:

- a) një pjesë e fondeve të programuara për shërbimet e përkujdesit shoqëror;
- b) financime jashtëbuxhetore nga organizata, persona fizikë ose juridikë apo individë të tjerë;

c) të ardhurat e tjera, që sigurohen nga zbatimi i drejtpërdrejtë i marrëveshjeve dy ose shumëpalëshe, që Republika e Shqipërisë lidh me shtetet e tjera;

ç) të ardhurat nga burimet e veta dhe nga pasuritë që zotëron Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale.

Rregullat e përdorimit të Fondit Shoqëror përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 40

Kontrolli për përdorimin e fondeve të ndihmës, pagesës për personat me aftësi të kufizuar dhe të shërbimeve të përkujdesit shoqëror bëhet nga organet e specializuara të kontrollit, në përputhje me ligjin nr. 9009, datë 13. 2. 2003 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik".

KREU VII

Neni 41

Sanksionet

Çdo shkelje e këtij ligji dhe e akteve nënligjore në zbatim të tij quhet kundërvajtje administrative, në mbështetje të ligjit nr. 7697, datë 7. 4. 1993 "Për kundërvajtjet administrative".

Neni 42

Dispozita kalimtare

1. Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale harton programin e kalimit të institucioneve të përkujdesit shoqëror në varësi të pushtetit vendor.

2. Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale harton dhe ndjek procedurat e transferimit të shërbimeve shoqërore dhe kalimin e institucioneve në varësi të qeverisjes vendore, duke filluar nga viti 2005 deri në vitin 2007.

3. Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale merr masat për transferimin e fondeve për të gjitha institucionet që transferohen në varësi të qeverisjes vendore.

4. Ministri i Punës dhe Çështjeve Sociale krijon Inspektoratin e Ndihmës Ekonomike, Pagesës për Personat me Aftësi të Kufizuar dhe Shërbimeve Shoqërore brenda vitit 2005.

5. Qarqet, bashkitë ose komunat ngarkohen të krijojnë e të plotësojnë strukturat për administrimin e skemës së ndihmës ekonomike, pagesës për aftësinë e kufizuar dhe të shërbimeve shoqërore, sipas nevojave, brenda vitit 2006.

Neni 43

Ngarkohet Këshilli i Ministrave për nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të neneve 10, 11, 18, 19, 20, 23, 26, 27, 29, 30, 35, 38 dhe 39 të këtij ligji.

Neni 44

Ligji nr. 7710, datë 18. 5. 1993 "Për ndihmën dhe përkujdesin shoqëror", i ndryshuar,

vendimet e Këshillit të Ministrave në zbatim të tij dhe neni 2 i ligjit nr. 8626, datë 22. 6. 2000 “Për statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik” shfuqizohen.

Neni 45

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekreten nr.4520, datë 25.3.2005 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

**VENDIM
Nr.179, datë 15.3.2005**

**PËR NGRITJEN E KOMISIONIT TË POSAÇËM TË KUVENDIT PËR ZBATIMIN E
LEGJISLACIONIT TË ZGJEDHJEVE**

Në mbështetje të neneve 24 dhe 55 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Konferencës së Kryetarëve të Grupeve Parlamentare,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

I. Ngrihet Komisioni i Posaçëm i Kuvendit për Kontrollin e Zbatimit të Legjislacionit për Zgjedhjet për Kuvendin të vitit 2005.

II. Komisioni i Posaçëm ka për detyrë:

a) të ushtrojë kontrollin parlamentar në lidhje me zbatimin e detyrimeve ligjore nga ana e institucioneve të ngarkuara me zbatimin e Kodit Zgjedhor;

b) të ndjekë dhe të kontrollojë procesin e përditësimit të listave të zgjedhësve për zgjedhjet për Kuvendin të vitit 2005;

c) të ndjekë dhe të kontrollojë zbatimin e kriterëve ligjore për ngritjen e administratës zgjedhore, si dhe procesin e kualifikimit të tyre për zbatimin e Kodit Zgjedhor;

ç) të ndjekë dhe të kontrollojë përgatitjen e nevojshme logjistike për zhvillimin e zgjedhjeve dhe plotësimin e nevojave financiare për administratën zgjedhore të të gjitha niveleve, si dhe të institucioneve të tjera të ngarkuara për zbatimin e Kodit Zgjedhor.

III. Komisioni përbëhet nga 13 anëtarë. Anëtarësia në Komisionin e Posaçëm përcaktohet me vendim të Kuvendit brenda 7 ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi.

IV. Komisioni i Posaçëm ushtron veprimtarinë deri në datën 15 maj 2005.

V. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI
Servet Pëllumbi**

VENDIM
Nr.180, datë 23.3.2005

**PËR MIRATIMIN E RAPORTIT PËRFUNDIMTAR DHE KONKLUSIONEVE TË
KOMISIONIT HETIMOR PARLAMENTAR PËR PROKURIMET PUBLIKE TË
KRYEMINISTRISË DHE MINISTRIVE**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës dhe të neneve 20, 21 dhe 22 të ligjit nr.8891, datë 2.5.2002 "Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit",

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Miratohet Raporti Përfundimtar dhe konkluzionet e Komisionit Hetimor Parlamentar, të ngritur me vendimin nr.158, datë 18.11.2005 "Për ngritjen e Komisionit Hetimor Parlamentar për Prokurimet Publike të Kryeministrisë dhe Ministrive".

II. Këtij Raporti i bashkëlidhet mendimi i pakicës në Komisionin Hetimor Parlamentar.

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Servet Pëllumbi

VENDIM
Nr.181, datë 24.3.2005

**PËR PËRBËRJEN E KOMISIONIT TË POSAÇËM PARLAMENTAR "PËR ZBATIMIN E
LEGJISLACIONIT TË ZGJEDHJEVE" NGRITUR ME VENDIMIN NR.179, DATË 15.3.2005**

Në mbështetje të nenit 77, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë si dhe nenit 24, pika 3 të Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Përbërja e Komisionit të Posaçëm ngritur me vendimin nr.179, datë 15.3.2005 "Për zbatimin e legjislacionit të zgjedhjeve" është si më poshtë:

Elmaz Sherifi	PS
Ylli Bufi	PS
Albert Çaçi	PS
Kristo Goçi	PDNJ
Ndue Preka	PA
Skënder Gjinushi	PSD
Neritan Ceka	PAD
Spartak Braho	LSI
Eqerem Spahia	LZHK
Sokol Olldashi	PD
Shaban Memia	PD

Fatos Beja PD
Nard Ndoka PDR
II.Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Servet Pëllumbi

DEKRET
Nr.4529, datë 8.4.2005

PËR LEJIM LËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92 pika “c” të Kushtetutës, të neneve 15,19 dhe 20 të ligjit nr.8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, bazuar edhe në propozimin e Ministrit të Rendit Publik,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

- | | |
|---|---|
| 1. Roland Thodhori Bollano | 21. Diana Andon Nikolla (Berxholi) |
| 2. Kleida Bensik Buchholtz (Köhler) | 22. Kevin Aleksandër Nikolla |
| 3. Mark Llesh Zadeja-Heinemann (Zadeja) | 23. Albina Zef Caliqi (Doda) |
| 4. Oresa Haxhi Nezaj (Dyrmishi) | 24. Desis Vasillaq Caliqi |
| 5. Chris Agim Nezaj | 25. Vinçens Pjetër Gjoka |
| 6. Dritan Ali Alsela | 26. Hanspeter Vinçens Gjoka |
| 7. Andis Paul Weidenfeld (Mitarja) | 27. Adriana Veiz Gjoka (Spahiu) |
| 8. Edlira Fetah Skënderasi (Reka) | 28. Marije Ndue Rack (Dukagjini) |
| 9. Ornela Ferdinand Skënderasi | 29. Dëfrim Myslim Kullolli |
| 10. Reshit Isa Mehmeti | 30. Natasha Sami Bullwinkel (Brihmani) |
| 11. Hanna Reshit Mehmeti | 31. Besar Fatos Durro |
| 12. David Reshit Mehmeti | 32. Dhurata Petrit Qiriazati (Shtini) |
| 13. Sokol Flamur Gagani | 33. Krenar Barjam goduni |
| 14. Donika Çesk Zadrime (Jaku) | 34. Leonard Petro Melonashi |
| 15. Agron Ali Flaum (Senaj) | 35. Rajmonda Muhamet Stadtler (Berberi) |
| 16. Albana Ibrahim Kosumi (Blakçori) | 36. Hylli Zyhdi Rrjolli |
| 17. Pranvera Qemal Nukan (Balluku) | 37. Merita Adem Rrjolli (Fishta) |
| 18. Sokol Thoma Naqellari | 38. Stela Hylli Rrjolli |
| 19. Alkid Skënder Kërliku | 39. Olsi Hylli Rrjolli |
| 20. Romeo Arben Ndreka | |

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

REZOLUTË

**PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË INSTITUCIONIT TË KONTROLLIT TË LARTË
TË SHETIT PËR VITIN 2004**

Në mbështetje të nenit 103 pika 2 të Rregullores së Kuvendit, pasi u njoh me Raportin për Veprimtarinë e Kontrollit të Lartë të Shtetit për Vitin 2004, Kuvendi konstaton se:

Veprimtaria e Kontrollit të Lartë të Shtetit është në përputhje me kërkesat e nenit 164 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë dhe ligjin nr. 8270, datë 31.12.1997 "Për Kontrollin e Lartë të Shtetit", i ndryshuar me ligjin nr.8599, datë 1.6.2000.

Kuvendi i Shqipërisë,

vlerëson veprimtarinë e deritanishme të Kontrollit të Lartë të Shtetit si institucioni më i lartë kushtetues i vendit i kontrollit ekonomik dhe financiar, duke kërkuar prej tij ngritjen në lartësinë e detyrimeve të tij kushtetuese dhe ligjore për miradministrimin e financave publike, nëpërmjet kontrollit të përdorimit të fondeve publike.

Kontrolli i Lartë i Shtetit është shndërruar tashmë në një institucion kushtetues i konsoliduar i kontrollit të administrimit të financave publike, i udhëhequr nga parimet e profesionalizmit, pavarësisë dhe respektimit të ligjit.

Kuvendi i Shqipërisë inkurajon përpjekjet e Kontrollit të Lartë të Shtetit për përvetësimin në një shkallë më të lartë të legjislacionit në fuqi, njohjen dhe zbatimin e standardeve të kontrollit, si element thelbësor i rritjes profesionale, për ndërtimin e një institucioni bashkëkohor që të ndihmojë në miradministrimin e financave publike.

Kuvendi kërkon që për vitin 2005 t'i kushtohet vëmendje e veçantë punës në drejtimet e mëposhtme:

1. Sigurimin e pavarësisë politike të institucionit, duke shmangur reagimet e politizuara të forcave politike, duke rritur nivelin profesional të kontrolleve.

2. Rritjen e besueshmërisë ndaj publikut, nëpërmjet ngritjes së nivelit profesional të kontrollorëve dhe përmirësimit të metodave dhe cilësisë së kontrollit ekonomik e financiar.

3. Forcimin e bashkëpunimit të Kontrollit të Lartë të Shtetit me Kuvendin dhe me komisionet e tij, e posaçërisht me Komisionin për Ekonominë dhe Financat për përmirësimin e legjislacionit ekzistues për funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit.

4. Ngritjen në një nivel më të lartë të bashkëpunimit me Prokurorinë e Përgjithshme, për të vënë para forcës së ligjit shpërdoruesit e fondeve publike.

5. Rritjen e bashkëpunimit me Kuvendin dhe me Këshillin e Ministrave për përmirësimin e kuadrit ligjor, sidomos në fushën e kontrollit të financave publike, të prokurimeve publike dhe të administrimit të vlerave materiale dhe monetare.

6. Vazhdimin e përmirësimit të mëtejshëm të praktikave të deritanishme në funksion të rritjes së transparencës së përdorimit të fondeve publike, si një mekanizëm efektiv për mirinformimin e opinionit publik.

7. Zhvillimin e sistemeve të efektshme të auditimit, të shprehura në Dokumentin Strategjik për Shqipërinë për vitin 2002-2006.

8. Përmbushjen e rekomandimeve të dhëna nga SIGMA për sigurimin e cilësisë së kontrollit, duke përcaktuar procedura dhe rregulla të qarta të institucionalizuara për këtë çështje.

9. Kryerjen e kontrolleve vlerësuese dhe cilësore për përdorimin e fondeve të Buxhetit të Shtetit për ndërtimin dhe rikonstruksionin e rrugëve, ujësjellësve dhe kanalizimeve, si dhe për shfrytëzimin e pasurive pyjore dhe minerare.

10. Kryerjen e kontrolleve për përdorimin e fondeve të marra hua nga institucionet financiare ndërkombëtare për ndërtimin dhe zhvillimin e infrastrukturës, energjetikës, ujitjes e kullimit dhe për projekte të tjera që ndërtohen me financim të huaj.

11. Ndërmarrjen e reformave në fushën e burimeve njerëzore, në funksion të përmirësimit të veprimtarisë kontrolluese.

Kuvendi i kërkon Këshillit të Ministrave:

- Të shqyrtojë rekomandimet e Kontrollit të Lartë të Shtetit për përmirësimin e legjislacionit në fuqi, në funksion të kërkesave të reja dhe në ndjekje të transformimeve të mëdha e të rëndësishme që po pëson ekonomia, në përshtatje me kërkesat e ekonomisë së tregut.

- Të rrisë më tej bashkëpunimin e Ministrit të Shtetit për Koordinim pranë Këshillit të Ministrave me institucionin e Kontrollit të Lartë të Shtetit në zbatim të detyrave që dalin nga kontrollet e ushtruara.

- Të zbatojë me rigorozitet masat e propozuara nga Kontrolli i Lartë i Shtetit për institucionet shtetërore të kontrolluara prej tij.

- Të përmirësojë punën për plotësimin organik, si dhe rritjen cilësore të auditimit të brendshëm, si një element efikas për parandalimin e shkeljeve financiare.

Me këtë rast, Kuvendi u kërkon të gjitha institucioneve shtetërore dhe organit të Prokurorisë të bashkërendojnë veprimtaritë e tyre me Kontrollin e Lartë të Shtetit për kontrollin e financave publike.

Tiranë, 17.3.2005

REZOLUTË

PËR GJENDJEN NË SHËRBIMIN CIVIL

Kuvendi i Shqipërisë,

- duke njohur domosdoshmërinë e krijimit të një shërbimi civil profesional dhe të qëndrueshëm;

- duke vlerësuar rëndësinë e krijimit dhe konsolidimit të një sistemi karriere në shërbimin civil;

- duke mbështetur zhvillimin e mëtejshëm dhe thellimin e reformave në shërbimin civil për sa i përket fushës së veprimit të tij nga njëra anë dhe përmirësimit cilësor të komponentëve përbërës të menaxhimit të burimeve njerëzore, nga ana tjetër;

- duke mundësuar për krijimin e institucioneve të reja dhe forcimin e atyre ekzistuese nëpërmjet miratimit të kuadrit ligjor përkatës, me qëllim zbatimin e legjislacionit të shërbimit civil;

- në mbështetje të nenit 4 të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 "Statusi i nëpunësit civil" dhe të nenit 103 pika 3 të Rregullores së Kuvendit, për vitin 2004,

Vlerësoi se:

- është rritur qëndrueshmëria në punë e nëpunësve civilë;

- është rritur profesionalizmi i nëpunësve bazuar në meritat profesionale dhe intelektuale;

- është përmirësuar procesi i realizimit të pranimit në shërbimin civil nëpërmjet procedurave të konkurrimit të hapur dhe publik;

- është rritur interesi për t'u punësuar në shërbimin civil dhe administratën publike në përgjithësi;

- janë forcuar kapacitetet e nevojshme për të gjithë komponentët e menaxhimit të burimeve njerëzore dhe zbatimit të legjislacionit të shërbimit civil;

- është siguruar shtrirja e reformës në administratën publike me komponentin e reformës

funkionale dhe strukturore, si dhe përmirësimin e procedurave të përdorimit të teknologjive të informacionit dhe komunikimit në veprimtarinë e brendshme të administratës publike;

- është konsoliduar veprimtaria e institucioneve të tilla, si Departamenti i Administratës Publike, Komisioni i Shërbimit Civil, Instituti i Trajnimit të Administratës Publike në procesin e reformës në shërbimin civil.

Për vitin 2005, Kuvendi i Shqipërisë kërkon të realizohen objektivat e mëposhtëm për shërbimin civil:

- kalimi i reformës në shërbimin civil në një etapë strategjike dhe cilësore, duke përfshirë edhe komponentët e tjerë të reformës në administratën publike;

- krijimi e kushteve të domosdoshme për fillimin e zbatimit të sistemit të karrierës në shërbimin civil;

- respektimi korrekt i procedurave të parashikuara nga legjislacioni i shërbimit civil për uljen e numrit të pozicioneve të lira në këtë shërbim, si dhe forcimi i strukturave të institucioneve, me qëllim unifikimin e strukturave mbështetëse, për të mundësuar standardizimin e përshtimeve të punës për pozicione të njëjta;

- hartimi i kurrikulave të reja trajnuese për t'iu përshtatur sa më mirë nëpunësve të institucioneve qendrore, duke shfrytëzuar kapacitetet më të mira intelektuale nëpërmjet ndërthurjes së përgatitjes akademike me prakticienë të fushave përkatëse;

- shtrirja e reformës në fushën e pagave nëpërmjet zbatimit të strukturës së re të pagave për institucionet në varësi të Këshillit të Ministrave, me qëllim krijimin e një sistemi pagash të harmonizuar, transparent e të mbështetur në vlerën relative të vendit të punës, si dhe në përputhje me përparësitë qeveritare;

- ndërgjegjësimi i titullarëve të institucioneve qendrore për respektimin e vendimeve të gjykatave në rastet e ankimeve nga punonjës të shërbimit civil;

- minimizimi i rasteve të largimit nga shërbimi civil për motive që nuk lidhen me masat disiplinore, ndryshimin e kërkesave të vendit të punës ose mbylljen dhe ristrukturimin e institucioneve të administratës publike;

- ngritja në një nivel më të lartë, sipas kërkesave të kohës, e bashkëveprimit institucional ndërmjet Komisionit të Shërbimit Civil dhe Departamentit të Administratës Publike;

- përmirësimi i vazhdueshëm i kuadrit ligjor ekzistues dhe korrigjimi i mangësive të evidentuara nga zbatimi në praktikë i reformës nëpërmjet zgjerimit të fushës së veprimit të ligjit "Statusi i nëpunësit civil", duke përfshirë në fushën e tij të veprimit kategori të tjera të institucioneve të administratës publike si "institucione në varësi të Këshillit të Ministrave", të ministrive të linjës, administratës së prefektit dhe komunave etj.;

- ndryshimi i procedurave të testimit për pranimin në shërbimin civil, me qëllim rritjen e cilësisë së "produktit" të testimit, rritjen e shpejtësisë për plotësimin e vendeve vakante, uljen e diskrecionit të përzgjedhjes së kandidatit për t'u emëruar në shërbimin civil, duke eliminuar mundësinë e përzgjedhjes nga eprori direkt dhe duke siguruar përzgjedhjen e kandidatit më të mirë.

Tiranë, më 21.3.2005

URDHËR

Nr.11, datë 25.3.2005

PËR MIRATIMIN E PRIMIT TË SIGURIMIT TË DETYRUESHËM TË MBAJTËSVE TË MJETEVE MOTORIKE PËR PËRGJEGJËSINË NDAJ PALËVE TË TRETA

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës, të nenit 16 të ligjit nr.7641, datë 1.12.1992 "Për miratimin me ndryshime të dekretit nr.295, datë 15.9.1992 "Për sigurimin e detyrueshëm të mbajtësve të mjeteve motorike për përgjegjësitë ndaj palëve të treta", i ndryshuar, dhe të rregullores nr.622/1, datë 15.12.1992 "Për zbatimin e sigurimit të detyrueshëm të mbajtësve të mjeteve motorike për përgjegjësitë ndaj palëve të treta", e ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Tarifat e primit të pastër (të rrezikut) për sigurimin e detyrueshëm për mbajtësit e mjeteve motorike për përgjegjësitë ndaj palëve të treta për kontratat me afat njëvjeçar do të jenë si më poshtë:

Kategoria	Klasa	Tipi i mjetit	Primi i pastër në lekë
A		Motoçikleta	2 600
B			
	.1	Autovetura	5 500
	.2	Mjete transporti pasagjerësh nga 5 - 15 vende	10 500
C			
	.1	Autobusa mbi 16 vende	17 300
D			
	.1	Mjete transporti mallrash të të gjitha llojeve deri 20 ton	12 000
	.2	Mjete transporti mallrash të të gjitha llojeve mbi 20 ton	14 000
E		Rimorkio të të gjitha llojeve	3 000
F		Mjete punimi në bujqësi	2 000
G		Zjarrfikëse	6 000

2. Tarifat e primit të pastër (të rrezikut) për sigurimin e detyrueshëm për mbajtësit e mjeteve motorike për përgjegjësitë ndaj palëve të treta për kontratat me afat 10-ditor do të jenë si më poshtë:

Kategoria	Klasa	Tipi i mjetit	Primi i pastër në lekë
A		Motoçikleta	300
B			
	.1	Autovetura	600
	.2	Mjete transporti pasagjerësh nga 5 - 15 vende	1 000
C			
	.1	Autobusa mbi 16 vende	4 000
D			
	.1	Mjete transporti mallrash të të gjitha llojeve deri 20 ton	1300
	.2	Mjete transporti mallrash të të gjitha llojeve mbi 20 ton	3 000
E		Rimorkio të të gjitha llojeve	1 300
F		Mjete punimi në bujqësi	700
G		Zjarrfikëse	1300

3. Tarifat e primit të pastër (të rrezikut) për sigurimin e detyrueshëm për mbajtësit e mjeteve motorike për përgjegjësitë ndaj palëve të treta për kontratat kufitare do të jenë si më poshtë:

Kategoria	Tipi i mjetit	Primi i pastër në euro				
		15 ditë	20 ditë	25 ditë	30 ditë	45 ditë
A	Autovetura	16	19	22	26	29
B.1	Motoçikleta	8	10	11	13	16
B.2	Motokarro	10	13	16	19	23
C.1	Kamion për mallra nga 15 deri 34.99 Kv	54	67	81	87	101
C.2	Kamion për mallra nga 35 Kv e lart	67	81	87	101	121
D	Çiklomotor	8	10	11	13	16
E	Autobusë	91	104	124	137	163
F.1	Rimorkio kamioni	40	47	53	60	73
F.2	Rimorkio autobusi	53	60	67	73	93
F.3	Rimorkio të tjera	20	27	33	40	47

4. Shpenzimet që do t'i shtohen primit të pastër përlogariten nga shoqëria e sigurimit dhe i njoftohen Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve.

5. Primi minimal i arkëtuar nga shoqëritë e sigurimit për kontratat e sigurimit të detyrueshëm të mbajtësve të mjeteve motorike për përgjegjësitë ndaj palëve të treta është i barabartë me primin e pastër (i rrezikut) duke i shtuar shpenzimet sipas pikës 4 të këtij urdhri.

6. Tarifat e primit maksimal nga shoqëritë e sigurimit për kontratat e sigurimit të detyrueshëm të mbajtësve të mjeteve motorike për përgjegjësitë ndaj palëve të treta janë si më poshtë:

Kontratat me afat 1-vjeçar

Kategoria	Klasa	Tipi i mjetit	Primi në lekë
A		Motoçikleta	7 000
B			
	B.1	Autovetura	15 000
	B.2	Mjete transporti pasagjerësh nga 5 - 15 vende	28 600
C			
	C.1	Autobusa mbi 16 vende	46 200
D			
	D.1	Mjete transporti mallrash të të gjitha llojeve deri 20 ton	31 600
	D.2	Mjete transporti mallrash të të gjitha llojeve mbi 20 ton	37 800
E		Rimorkio të të gjitha llojeve	9 200
F		Mjete punimi në bujqësi	7 100
G		Zjarrfikëse	16 400

Kontratat me afat 10-ditor

Kategoria	Tipi i mjetit	Primi në lekë
A	Motoçikleta	900
B		
	B.1 Autovetura	1700
	B.2 Mjete transporti pasagjerësh nga 5 - 15 vende	3500
C		
	C.1 Autobusa mbi 16 vende	10 500
D		
	D.1 Mjete transporti mallrash të të gjitha llojeve deri 20 ton	3 500
	D.2 Mjete transporti mallrash të të gjitha llojeve mbi 20 ton	7 000
E	Rimorkio të të gjitha llojeve	3 500
F	Mjete punimi në bujqësi	1700
G	Zjarrfikëse	3 500

Kontratat kufitare

Kategoria	Tipi i mjetit	Primi në euro				
		15 ditë	20 ditë	25 ditë	30 ditë	45 ditë
A	Autovetura	44	52	61	70	78
B.1	Motoçikleta	21	26	30	35	44
B.2	Motokarro	26	35	44	52	61
C.1	Kamion për mallra nga 15 deri 34.99 Kv	140	174	209	227	262
C.2	Kamion për mallra nga 35 Kv e lart	174	209	227	262	314
D	Çiklomotor	21	26	30	35	44
E	Autobusë	244	279	331	366	436
F.1	Rimorkio kamioni	105	122	140	157	192
F.2	Rimorkio autobusi	140	157	174	192	244
F.3	Rimorkio të tjera	52	70	87	105	122

7. Provigjoni teknik i sigurimit të detyrueshëm për mbajtësit e mjeteve motorike për përgjegjësitë ndaj palëve të treta përjashtuar kartonin jeshil, përlllogaritët si shumë e provigjonit teknik të primit të pafitur dhe provigjonit teknik të dëmeve.

8. Ky provigjon teknik llogaritet në mënyrë të përmuajshme për të gjitha dëmet pezull dhe policat e sigurimit në fuqi në ditën e fundit të muajit, deri në datën 15 të muajit pasardhës.

9. Përlllogaritja e provigjonit teknik e primit të pafitur bëhet me metodën e numrit ekzakt të ditëve të policës së sigurimit.

10. Provigjoni teknik i dëmeve përlllogaritët mbi bazën e dëmeve pezull duke i shtuar vlerën prej 30% të këtij të fundit.

11. Provigjoni teknik i sigurimit të detyrueshëm për mbajtësit e mjeteve motorike për përgjegjësitë ndaj palëve të treta përjashtuar kartonin jeshil, ngurtësohet në një llogari të veçantë në një nga bankat e nivelit të dytë dhe prekja e tij nga ana e shoqërive të sigurimit bëhet vetëm me

autorizim nga Autoriteti Mbikëqyrës i Sigurimeve, me qëllim pagesën e dëmeve që lindin nga ky lloj sigurimi, dhe axhustimet e mundëshme në këtë lloj provigjoni teknik.

12. Kontrolli i provigjoneve teknike nga ana e Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve të bëhet i përmuajshëm deri në datën 20 të muajit pasardhës.

13. Përlllogaritja e TVSH-së bëhet konform ligjit “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”. Shoqëritë e sigurimeve çelin llogari të veçantë në bankat e nivelit të dytë për derdhjen e vlerave të TVSH –së.

14. Tarifat e primeve dhe provigjoni teknik të sigurimit të detyrueshëm për mbajtësit e mjeteve motorike për përgjegjësinë ndaj palëve të treta, të përcaktuara në këtë urdhër, janë të detyrueshme për t’u zbatuar nga shoqëritë e sigurimit duke filluar nga data 1.4.2005. Moszbatimi i tarifave të primeve të përcaktuara në këtë urdhër i bën shoqëritë e sigurimit subjekt të sanksioneve të përcaktuara në nenin 165- e vijues të ligjit nr.9267, datë 29.7.2004 “Për veprimtarinë e sigurimit, risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime”.

15. Ngarkohen shoqëritë e sigurimit, Autoriteti Mbikëqyrës i Sigurimeve dhe Byroja Shqiptare e Sigurimit të marrin masat për zbatimin e këtij urdhri.

16. Urdhri i Ministrit të Financave nr.2262, datë 1.4.2003 “Për miratimin e primit neto të sigurimit të detyrueshëm të mbajtësve të mjeteve motorike për përgjegjësinë ndaj palëve të treta”, dhe të gjitha aktet e tjera të dala në zbatim të tij, shfuqizohen.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCEVE
Arben Malaj

GJYKATA EUROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT SEKSIONI I KATËRT

Vendim lidhur me pranueshmërinë e aplikimit nr.10513/03 nga Stefan Naumov kundër Shqipërisë, depozituar më 3 dhjetor 2002

Gjykata Europiane për të Drejtat e Njeriut (seksioni i katërt), e mbledhur më 4 janar 2005 si Dhomë e përbërë prej:

Z.Nikolas Bratza, President

Z.M.Pelonpaa

Z.R.Maruste

Z.K.Traja

Z.S.Pavlovski

Z.L.Garlicki

Z.J.Sikuta, gjyqtarët

dhe znj.F.Elens-PASSOS, zëvendësregjistrar i seksionit,

duke u mbështetur në aplikimin e mësipërm të depozituar më 3 dhjetor 2002,

duke u mbështetur në vëzhgimet e paraqitura nga qeveria përgjegjëse dhe vëzhgimet e paraqitura nga aplikanti,

pasi ka diskutuar çështjen ka vendosur si më poshtë:

PËRSA U PËRKET FAKTEVE

Aplikanti z.Stefan Naumov është një shtetas shqiptar, i cili ka lindur më 1945 dhe jeton në Tiranë (Shqipëri).

A. Rrethanat e çështjes

Faktet e çështjes siç janë paraqitur nga aplikanti mund të përmbledhen si më poshtë:

Aplikanti, një shtetas bullgar, ka qenë Ambasadori Bullgar në Republikën e Shqipërisë nga viti 1990 deri në vitin 1997.

Më 1996 Ministria e Punëve të Jashtme të Bullgarisë inicoi procedim ligjor kundër aplikantit si rrjedhojë e të cilave ai u pezullua nga puna me anë të një urdhri të ministrit.

Më 10 shkurt 1997 Gjykata e Lartë e Bullgarisë anuloi urdhrin e ministrit që e pushonte aplikantin nga puna. Në një ditë të papërcaktuar aplikanti u tërhoq nga jeta politike.

Më 1997 aplikanti dhe familja e tij i kërkuan Presidentit të Republikës së Shqipërisë shtetësinë

shqiptare. Më 17 prill 1997 Presidenti i Republikës u dha atyre shtetësinë shqiptare.

Më 20 shtator 2001 Presidenti i Republikës së Shqipërisë, i zgjedhur së fundi, në mënyrë *ex officio* ka deklaruar nul dhe të pavlefshëm dekretin e presidentit të datës 17 prill 1997 duke revokuar në këtë mënyrë shtetësinë shqiptare të aplikantit me arsyen se ishte siguruar me anë të dokumenteve të falsifikuara. Sipas dekretit, aplikanti kishte paraqitur dokumente të falsifikuara për të treguar se kundër tij nuk ishte filluar asnjë procedim penal në Bullgari.

Më 2 tetor 2001, rreth orës 9.00 një grup me punonjës policie, disa prej tyre të armatosur, shoqëruan aplikantin, së bashku me gruan e tij, në rajonin e policisë së Tiranës për njoftimin zyrtar të dekretit.

Pas disa orësh pritje, aplikantit i është dhënë një kopje e dekretit të presidentit të datës 20 shtator 2001, me anë të të cilit i hiqej shtetësia shqiptare.

Për më tepër, zëvendëshefi i Drejtorisë së Policisë Tiranë urdhëroi verbalisht aplikantin që të largohej nga territori i Shqipërisë më 5 tetor 2001 (d.m.th. brenda tri ditësh) në zbatim të një urdhri dëbimi datë 29 shtator 2001 ose përndryshe do të dëbohej me forcë.

Më 2 tetor 2001 Ministria e Punëve të Brendshme lëshoi një njoftim për shtyp sipas të cilit aplikanti ishte urdhëruar të linte territorin e Shqipërisë më 5 tetor 2001, meqenëse shtetësia shqiptare, që ai kishte fituar me anë të dokumenteve të falsifikuara, i ishte hequr.

Më 4 tetor 2001, policia pa asnjë arsye të dukshme e ndaloi aplikantin dhe familjen e tij të lëvizte nga apartamenti i tyre. Situata u zgjidh me anë të ndërhyrjes së një anëtarit të Parlamentit. Më 5 tetor 2001 aplikanti mori një letër nga Drejtoria e Policisë që i kujtonte atij largimin nga territori i Shqipërisë deri në mesnatën e asaj dite.

1. Procedurat kundër dekretit të Presidentit që revokonin shtetësinë

Më 2 tetor 2001 aplikanti depozitoi një padi në Gjykatën e Rrethit Tiranë duke pretenduar se dekreti i Presidentit të datës 20 shtator 2001, duhej të anulohet si antikushtetues. Për më tepër ai ka kërkuar si masë të përkohshme, që ekzekutimi i urdhrit të dëbimit të pezullohej.

Më 4 tetor 2001 gjykata e rrethit refuzon juridiksionin për shqyrtimin e ankesës së aplikantit dhe përcaktoi Gjykatën Kushtetuese si autoritetin kompetent.

Më 31 dhjetor 2001 Gjykata e Lartë (Kolegji Civil) prishi vendimin e gjykatës së rrethit të datës 4 tetor 2001 dhe e dërgoi çështjen për rigjykim në gjykatën e rrethit si autoritetin kompetent për shqyrtimin e ankimit të aplikantit.

Më 23 dhjetor 2002, pas një viti mosveprimi, gjykata e rrethit në rigjykimin e çështjes, vendosi të anulohet dekreti e Presidentit të datës 20 shtator 2001 si të pambështetur, duke konfirmuar në këtë mënyrë shtetësinë shqiptare të aplikantit.

2. Procedurat kundër urdhrit të dëbimit dhe urdhrit të policisë

Më 5 tetor 2001 aplikanti depozitoi një padi në gjykatën e rrethit Tiranë duke pretenduar që urdhri i dëbimit i datës 29 shtator 2001 dhe urdhri i policisë i datës 5 tetor 2001 të anuloheshin dhe të hidheshin poshtë.

Në bazë të fakteve të paraqitura nga aplikanti, gjykimi në Gjykatën e Shkallës së Parë ka zgjatur 2 vjet dhe 6 muaj dhe janë zhvilluar 14 seanca dëgjimore. Seancat gjyqësore janë shtyrë në disa raste si rezultat i mungesës së pajustifikuar të këshilltarëve ligjorë të Drejtorisë së Policisë dhe të Ministrisë së Punëve të Brendshme. Këta të fundit kanë munguar në 13 seanca gjyqësore pa dhënë asnjë arsye.

Më 25 mars 2002 gjykata e rrethit ka pezulluar shqyrtimin e ankimit të aplikantit deri në momentin që gjykata të vendoste mbi vlefshmërinë e dekretit të Presidentit.

Më 7 shkurt 2003 gjykata përfundon gjykimin. Brenda një viti ajo ka zhvilluar 4 seanca dëgjimore dhe në mungesë të përfaqësuesve të autoriteteve, ka vazhduar procedurat vetëm në prezencën e aplikantit.

Më 20 mars 2003, në mungesë të përfaqësuesve të autoriteteve, gjykata e rrethit ka anuluar urdhrin e dëbimit dhe urdhrin e policisë të datës 5 tetor 2001 si të pambështetur në kriteret ligjore.

B. E drejta e brendshme

1. Neni 92 i Kushtetutës së Shqipërisë parashikon që Presidenti i Republikës ka fuqinë të japë dhe të heqë shtetësinë shqiptare në përputhje me ligjin.

2. Pjesa përkatëse e ligjit nr.8389 të datës 5 gusht 1998 mbi dhënien dhe heqjen e shtetësisë shqiptare, shprehet si më poshtë.

Neni 9
Dhënia e shtetësisë me anë të natyralizimit

“Një shtetas i huaj që ka paraqitur një aplikim për përfitimin e shtetësisë shqiptare me anë të natyralizimit duhet të sigurojë nëse i plotëson kërkesat e mëposhtme:

Ai të ketë arritur moshën 18 vjeç; ai ka jetuar në mënyrë të ligjshme në territorin e Republikës së Shqipërisë për jo më pak se 5 vjet të njëpasnjëshme; ai ka të ardhura të mjaftueshme dhe shtëpi banimi; ai nuk ka qenë asnjëherë i dënuar në vendin e tij ose në Republikën e Shqipërisë, ose në një shtet të tretë për një vepër penale për të cilën ligji parashikon vendimin me burgim për jo më pak se 3 vjet. Përfundimisht nga ky rregull bëhet vetëm nëse provohet që vendimi i dënimit është dhënë për arsye politike; ai ka së paku njohuri elementare të gjuhës shqipe; dhe pranimi i tij si një shtetas shqiptar nuk prek sigurinë dhe mbrojtjen e Republikës së Shqipërisë...”

Neni 13

Revokimi i vendimit për dhënien e shtetësisë

“Vendimi për dhënien e shtetësisë shqiptare mund të revokohet nëse provohet që të huajt ose personat pa shtetësi kanë mbështetur në mënyrë të qëllimshme aplikimin e tyre për fitimin e shtetësisë shqiptare mbi të dhëna jo të sakta dhe dokumente të falsifikuara...”

PRETENDIMET

1. Aplikanti ankohet në bazë të nenit 5/1 të Konventës për heqjen e lirisë.
2. Duke u mbështetur në nenin 6/1 të Konventës, aplikanti ankohet për procedura të gjata, të padrejta dhe mungesë të pavarësisë dhe paanësisë në gjykatat vendase në gjykimet lidhur me shtetësinë dhe dëbimin e tij.
3. Aplikanti i referohet nenit 8 të Konventës në lidhje me urdhrin e tij të dëbimit.
4. Mbështetur në nenin 10 të Konventës, aplikanti ankohet për persekutimin që ai ka vuajtur për shkak të bindjeve të tij politike.
5. Së fundi ai pretendon shkelje të nenit 3 të protokollit nr.4 dhe/ose nenit 1 të protokollit 7 të Konventës.

PËRSA I PËRKET SË DREJTËS

Aplikanti ankohet për ndalimin e tij të paligjshëm në rajonin e policisë, duke iu referuar nenit 5/1 të Konventës, i cili për aq sa ka lidhje shprehet si më poshtë:

“1. Çdokush ka të drejtën e lirisë dhe sigurisë personale. Askujt nuk mund t’i hiqet liria, me përjashtim të rasteve që vijnë dhe në përputhje me procedurën e parashikuar nga ligji.

(f)...në rastet e arrestimit ose burgimit të rregullt të një personi për të parandaluar hyrjen e paligjshme të tij në një vend ose të një personi ndaj të cilit po kryhet një procedurë dëbimi ose ekstradimi...”

Ankimi i aplikantit sipas kësaj dispozite lidhet me kohën që ai ka kaluar në rajonin e policisë për një afat të papërcaktuar më 2 tetor 2001, e cila sipas tij përbën “heqje të lirisë” sipas kuptimit të nenit 5/1 të Konventës.

Gjykata thekson se sipas nenit 35/1 të Konventës, ajo mund të shqyrtojë vetëm ankime, për të cilat janë ezauruar mjetet e brendshme të ankimit dhe të cilat janë paraqitur brenda 6 muajsh nga data e vendimit përfundimtar të brendshëm. Në mungesë të një ankimi të përshtatshëm kundër një akti të veçantë, i cili pretendohet të ketë qenë shkelje e Konventës, data kur është marrë ky akt do të konsiderohet si “përfundimtar”, në kuptim të zbatimit të afatit 6-mujor (shih Valasinas vs.Lithuania, nr.44558/98, 14 mars 2000).

Gjykata, së pari konstaton se aplikanti nuk ka filluar procedura gjyqësore në lidhje me shkeljen e pretenduar të së drejtës së tij sipas nenit 5 të Konventës.

Për më tepër duke pranuar se aplikanti nuk ka ankim ligjor sipas kuptimit të nenit 35/1, lidhur me pretendimin “heqje lirie”, referuar qëndrimin të tij në rajonin e policisë, ngjarjet për të cilat ankohet në këtë rast lidhen me datën 2 tetor 2001, që është më shumë se 6 muaj përpara se aplikimi të depozitohet në datën 3 dhjetor 2002. Si pasojë kjo pjesë e aplikimit është paraqitur jashtë afatit kohor.

Për rrjedhojë, kjo pjesë e aplikimit duhet të hidhet poshtë, në mbështetje të nenit 35, paragrafët 1 dhe 4 të Konventës.

2. Aplikanti ka pretenduar se ka pasur një numër shkeljesh të nenit 6/1 të Konventës i cili për

këtë rast shprehet si më poshtë:

“Për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat civile dhe detyrimet...çdokujt i njihet e drejta për një proces të rregullt...brenda një periudhe kohe të arsyeshme nga një trup gjykues i pavarur dhe i paanshëm i krijuar me ligj...”

Në zbatim të procedurave që lidhen me heqjen e shtetësisë dhe dëbimit, aplikanti ankohet që nuk i është dhënë mundësia për një proces të rregullt gjyqësor, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme. Për më tepër aplikanti ankohet që kohëzgjatja e procedurave nuk ka qenë në përputhje me kërkesën “kohë të arsyeshme”.

Që në fillim gjykata rithekson se neni 6/1 i Konventës nuk aplikohet për procedurat që rregullojnë shtetësinë e personave dhe/ose hyrjen, qëndrimin dhe dëbimin e të huajve, pasi procedura të tilla nuk përfshijnë “përcaktimin e të drejtave të tij civile apo detyrimet ose ndonjë akuzë penale kundër tij” në kuptimin e nenit 6/1 të Konventës (shih ndërmjet autoriteteve të tjera, S.Switzerland nr.13325/87, 15 dhjetor 1988, Soc.k.Kroacisë nr.47 863/9, 29 qershor 2000).

Në kuadrin e këtyre rrethanave, gjykata vëren se neni 6/1 i Konventës nuk zbatohet për procedurat që kanë të bëjnë me heqjen e shtetësisë. Në këtë mënyrë, kjo pjesë e aplikimit duhet të rrëzohet si jo në përputhje me parimin *ratione material* e sipas përcaktimeve të Konventës, në zbatim të nenit 35, paragrafët 3 dhe 4 të Konventës.

3. Aplikanti ka parashtruar se autoritetet shqiptare i kanë shkelur të drejtën për të respektuar jetën e tij private dhe të familjes të garantuar nga neni 8 i Konventës, i cili shprehet si më poshtë:

“1. Çdonjëri ka të drejtë që t’i respektohet jeta private dhe familjare....

2. Autoriteti publik nuk mund të ndërhyjë në ushtrimin e kësaj të drejte, përveçse në shkallën e parashikuar nga ligji dhe kur në një shoqëri demokratike kjo masë është e nevojshme në interesat e sigurisë kombëtare, sigurisë publike ose të mirëqenies ekonomike të vendit, për mbrojtjen e rendit dhe parandalimin e krimeve, për mbrojtjen e shëndetit ose moralit ose për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të tjerëve.”.

Aplikanti ankohet lidhur me publikimin në opinionin publik dhe shpalljen e bërë me këtë rast me anë të shtypit për dëbimin e tij si rrjedhojë e heqjes së shtetësisë së tij shqiptare nga ana e Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Aplikanti ankohet se ky demaskim duhet konsideruar si shkelje e së drejtës së tij për t’i respektuar jetën e tij private dhe reputacionin e tij, pavarësisht nga ligjshmëria e aktit që i heq atij shtetësinë shqiptare.

Gjykata vëren se, ashtu si në rastin e ankimit të tij për nenin 5 të Konventës, aplikanti nuk ka çelur një procedim gjyqësor në lidhje me shkeljen e pretenduar të së drejtës së tij sipas nenit 8 të Konventës.

Duke presupozuar që aplikanti nuk ka asnjë ankim ligjor për pretendimin e tij lidhur me demaskimin publik për shkak të heqjes së shtetësisë së tij, gjykata vëren se një demaskim i tillë ka ndodhur më 2 tetor 2001, që është më shumë se 6 muaj përpara se aplikimi të depozitohet më 3 dhjetor 2002. Si pasojë kjo pjesë e ankimit është paraqitur jashtë afatit.

Për rrjedhojë, kjo pjesë e aplikimit duhet të hidhet poshtë në zbatim të nenit 35, paragrafët 1 dhe 4 të Konventës.

4. Aplikanti është ankuar se persekutimi që ai ka vuajtur për arsye të bindjeve të tij politike dhe të kaluarës së tij demokratike, është shkelje e nenit 10 të Konventës që shprehet si më poshtë vijon:

“1. Çdokush ka të drejtën e lirisë së shprehjes. Kjo e drejtë përfshin lirinë e mendimit dhe lirinë për të marrë e dhënë informacione dhe ide pa ndërhyrjen e autoriteteve publike dhe pa marrë parasysh kufijtë. Ky nen nuk i ndalon shtetet nga kërkesa për licencimin e sipërmarrjeve të radiodifuzionit, kinemasë dhe televizionit.

2. Ushtrimi i këtyre lirive që mbartin detyrime dhe përgjegjësi, mund të jetë subjekt i disa formaliteteve, kushteve, kufizimeve ose penalizimeve siç janë parashikuar nga ligji dhe që janë të nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë kombëtare, integritetit territorial ose sigurisë publike për mbrojtjen e rendit, parandalimin e krimeve, për mbrojtjen e shëndetit dhe të moralit, për mbrojtjen e dinjitetit ose të drejtave të tjerëve për parandalimin e përhapjes së informacionit konfidencial ose për ruajtjen e autoritetit dhe të paanshmërisë së pushtetit gjyqësor.”.

Gjykata vëren se aplikanti nuk ka paraqitur ndonjë provë në mbështetje të pretendimeve të tij. Për rrjedhojë gjykata është e mendimit se aplikanti nuk ka mundur të provojë thëniet e tij dhe të paraqesë një pretendim të argumentuar për shkelje të këtij neni.

Kështu që, ky ankim është haptazi i pabazuar dhe duhet të hidhet poshtë në zbatim të nenit 35, paragrafët 3 dhe 4 të Konventës.

5. Aplikanti ankohet në mënyrë të alternuar se urdhri i dëbimit ka shkelur nenin 3 të protokollit nr.4 ose nenin 1 të protokollit nr.7 të Konventës.

Neni 3 i protokollit nr.4 të Konventës në pjesën përkatëse shprehet si më poshtë:

“1. Askush nuk mund të dëbohet me anë të një mase individuale ose kolektive, nga territori i shtetit, shtetas i të cilit është.”.

Neni 1 i protokollit nr.7 të Konventës, në pjesën përkatëse shprehet si më poshtë:

“1. Një i huaj, rezident i ligjshëm në territorin e një shteti nuk mund të dëbohet prej aty, përveçse në rast se zbatohet një vendim i cili është nxjerrë në përputhje me ligjin dhe duhet të ketë mundësi:

a) të paraqesë arsyet kundër dëbimit të tij,
b) të kërkojë rishikimin e çështjes së tij,
c) të përfaqësohet për këtë qëllim përpara autoriteteve kompetente ose një apo disa personave të caktuar nga ky autoritet.

2. Një i huaj mund të dëbohet para se të ushtrohen të drejtat e tij sipas paragrafit 1 (a), (b) dhe (c) të këtij neni, kur një dëbim i tillë është i nevojshëm në interes të rendit publik ose është i bazuar në arsyet e sigurisë kombëtare.”.

Aplikanti pohon se urdhri i dëbimit ishte shkelje e nenit 3 të protokollit nr.4 ose nenit 1 të protokollit nr.7, pasi nuk ishte përcaktuar se kur merrte fuqi ligjore dekreti i Presidentit i datës 20 shtator 2001 që revokonte shtetësinë shqiptare të tij.

Lidhur me ankimin e aplikantit për nenin 3 të protokollit nr.4, gjykata vëren se për arsye të dekretit të Presidentit, datë 20 shtator 2001, aplikanti nuk kishte shtetësi shqiptare në kohën e lëshimit të urdhrit të dëbimit të tij më 29 shtator 2001.

Edhe pse në disa raste revokimi i shtetësisë i ndjekur me dëbim mund të sjellë probleme potenciale sipas nenit 3 të protokollit nr. 4, nisur nga fakti që urdhri i dëbimit nuk është ekzekutuar, gjykata vëren se në rastin konkret nuk ka elemente të shkeljes së këtij neni.

Për rrjedhojë kjo pjesë e aplikimit është haptazi e pabazuar dhe duhet të refuzohet në zbatim të nenit 35, paragrafët 3 dhe 4 të Konventës.

Përsa i përket ankimit të aplikantit sipas nenit 1 të protokollit nr.7, gjykata vëren se aplikanti asnjëherë nuk u dëbua nga Shqipëria dhe nuk janë ndërmarrë masa për zbatimin forcërisht të urdhrave të policisë të datave 29 shtator dhe 5 tetor 2001. Për më tepër aplikanti ishte në gjendje të paraqesë arsyet kundër dëbimit të tij dhe çështja e tij u rishikua nga gjykatat vendase, të cilat më 20 mars 2003 kanë deklaruar urdhrat të pavlefshëm duke ndjekur anulimin e dekretit të Presidentit që i hiqte shtetësinë shqiptare aplikantit.

Prandaj ankim i aplikantit sipas nenit 1 të protokollit nr.7 është i papranueshëm dhe haptazi i pabazuar dhe duhet të hidhet poshtë, në përputhje me nenin 35, paragrafët 3 dhe 4 të Konventës.

Për këto arsye, gjykata në mënyrë unanime,
deklaron aplikimin të papranueshëm.

Zëvendësregjistrar
Francoise Elens-Passos

President
Nicolas Bratza

VENDIM **Nr.28, datë 30.3.2005**

I KËSHILLIT MBIKËQYRËS TË BANKËS SË SHQIPËRISË

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES
“PËR MBIKËQYRJEN E TRANSAKSIONEVE BANKARE NË RRUGË ELEKTRONIKE”

Neni 1
Baza ligjore

Kjo rregullore nxirret në zbatim të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë” dhe të ligjit nr.8365, datë 2.7.1998 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”.

Neni 2
Qëllimi

Kjo rregullore ka për qëllim të përcaktojë:

- a) kushtet organizative, kushtet në lidhje me personelin dhe kushtet teknike për realizimin e veprimtarisë bankare në rrugë elektronike (*e-banking*);
- b) kërkesat lidhur me verifikimin e kryer nga Banka e Shqipërisë për shërbimin *e-banking*;
- c) parimet e administrimit të rrezikut të shërbimit *e-banking*.

Neni 3
Subjektet

Subjekt i kësaj rregulloreje janë të gjitha bankat dhe degët e bankave të huaja (më poshtë bankat), që kryejnë veprimtari bankare në Republikën e Shqipërisë dhe që synojnë kryerjen e veprimtarisë bankare në rrugë elektronike.

Neni 4
Përcaktime

E-banking është shërbimi në distancë, nëpërmjet kanaleve elektronike të shpërndarjes dhe të komunikimit, i produkteve dhe i shërbimeve tradicionale dhe të reja bankare, brenda veprimtarive të lejuara për bankat e nivelit të dytë.

Neni 5
Ndalimet

- a) Bankat nuk lejohet të hapin llogari *e-banking* pa praninë fizike të klientit në bankë dhe pa kryer identifikimin e tij ose të përfaqësuesit të tij të autorizuar ligjërisht, mbështetur edhe në rregulloret e brendshme të miratuara. Banka ruan dokumentacionin që provon identifikimin e klientit, të paktën për një periudhë 5-vjeçare.
- b) Bankat nuk lejohet të kryejnë shërbimin *e-banking*, pa u verifikuar më parë për kushtet e kryerjes së tij nga Banka e Shqipërisë.

Neni 6
E drejta për kryerjen e veprimtarisë e-banking

Bankat mund të kryejnë *e-banking* vetëm pas verifikimit për plotësimin e kushteve nga ana e Bankës së Shqipërisë. Pas përgatitjeve, banka njofton Bankën e Shqipërisë për kryerjen e verifikimit. Njoftimi shoqërohet me:

- a) vendimin e këshillit drejtues të bankës për përdorimin e *e-banking* në kryerjen e veprimtarive të bankës;
- b) curriculum vitae të përgjegjësit direkt dhe të personelit teknik që do të mbështesë bankën në realizimin e veprimtarisë së *e-banking*, e cila duhet të përmbajë edhe kualifikimet dhe përvojën e punës së tyre;
- c) të dhënat që tregojnë kërkesat teknike të nevojshme për drejtimin dhe kontrollin e *e-banking*;
- d) vlerësimin e efekteve të përdorimit të *e-banking* në rezultatin e bankës nëpërmjet pasqyrave financiare për tre vitet e ardhshme;
- e) procedurat e funksionimit të *e-banking* dhe programi i kontrollit të brendshëm për këtë

qëllim;

f) marrëveshjen e nënshkruar me shoqërinë për realizimin e mbështetjes informatike të bankës, nëse ka të tillë ose nëse lidhet pas marrjes së autorizimit;

g) listën e transaksioneve bankare që do të kryejnë, së bashku me kanalet e komunikimit që do të përdorin.

Neni 7

E drejta e kryerjes së shërbimit dhe pezullimi i shërbimit

a) Pas njoftimit në Bankën e Shqipërisë sipas nenit 6, si edhe pas kryerjes së një verifikimi nga inspektorët e Bankës së Shqipërisë mbi vlerësimin e kushteve teknike, banka ka të drejtë të kryejë shërbimin e *e-banking*.

b) Banka e Shqipërisë mund të urdhërojë bankën të pezullojë në mënyrë të pjesshme ose të plotë shërbimin e *e-banking*, nëse gjatë procesit të mbikëqyrjes nga Banka e Shqipërisë vërehet se banka nuk ka respektuar kërkesat e kësaj rregulloreje.

c) Në rastin e pezullimit të pjesshëm, banka ndërpret brenda 60 ditësh shërbimin *e-banking* të pezulluar dhe njofton për këtë Bankën e Shqipërisë. Banka nuk mund të rifillojë këtë shërbim pa kaluar një periudhë prej 6 muajsh nga pezullimi i tij. Kushtet e rifillimit janë të njëjta si në nenin 6.

d) Në rastin e pezullimit të plotë, banka ndërpret brenda 60 ditësh shërbimin *e-banking* dhe njofton për këtë Bankën e Shqipërisë. Banka nuk mund të rifillojë këtë shërbim pa kaluar një periudhë prej 18 muajsh nga pezullimi i tij. Kushtet e rifillimit janë të njëjta si në nenin 6.

Neni 8

Kërkesa pas fillimit të shërbimit

a) Banka njofton paraprakisht Bankën e Shqipërisë për të gjitha shtesat në listën e kanaleve të komunikimit dhe në transaksionet bankare që kryen në rrugë elektronike, të cilat ndodhin pas fillimit të shërbimit *e-banking*.

b) Banka e Shqipërisë ka të drejtë të kërkojë plotësimin e dokumentacionit të nenit 6 për të gjitha ndryshimet dhe të kryejë verifikime të kushteve teknike, kur e gjykon të arsyeshme.

Neni 9

Kontabiliteti

Bankat bëjnë regjistrimet kontabël për veprimet e kryera edhe për *e-banking*, duke zbatuar ligjin “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe “Manualin e kontabilitetit bankar”.

PARIMET E ADMINISTRIMIT TË RREZIKUT TË E-BANKING

Neni 10

Mbikëqyrja efektive

Këshilli drejtues dhe drejtuesit e lartë ekzekutivë, duhet të krijojnë një mbikëqyrje efektive të administrimit të rreziqeve që shoqërojnë veprimtaritë e *e-banking*, duke përfshirë vendosjen e përgjegjësisë, të politikave dhe të kontrolleve specifike për të administruar këto rreziqe. Për këtë ata duhet që, në mënyrë të dokumentuar:

a) të përcaktojnë qartë rrezikun e bankës në lidhje me *e-banking*;

b) të përcaktojnë autoritetet, kompetencat e tyre dhe mekanizmat e raportimit, duke përfshirë procedurat e nevojshme të veprimit sipas shkallëve të përgjegjësisë në raste thyerjeje të sigurisë (si

penetrimi nëpërmjet rrjetit, shkelje të kërkesave të sigurisë nga të punësuarit, ndonjë keqpërdorim serioz i pajisjeve të kompjuterave etj.) që ndikojnë në sigurinë e shërbimit, në gjendjen dhe në reputacionin e bankës;

c) të vlerësojnë faktorët unikë të rrezikut për garantimin e sigurisë, të integritetit dhe të disponueshmërisë së produkteve dhe të shërbimeve *e-banking*, dhe të zbatojnë kërkesën që palët e treta, me të cilat banka ndan/përdor sistemet apo aplikimet kryesore, të marrin të njëjtat masa;

d) të garantojnë që *due diligence* dhe analiza e rrezikut janë realizuar para kryerjes së veprimtarive me jashtë (*cross-border*);

e) të përcaktojnë burimet që kërkohen për të mbikëqyrur shërbimet e *e-banking* në përpjesëtim me funksionimin operacional dhe me rrezikshmërinë e sistemeve, dobësitë e rrjeteve dhe ndjeshmëritë (natyrën) e informacioneve që transmetohen.

Neni 11

Infrastruktura e kontrollit të cilësisë

Këshilli drejtues dhe drejtuesit e lartë ekzekutivë duhet të rishikojnë dhe të miratojnë orientimet kryesore të procesit të kontrollit të sigurisë së bankës.

a) Këshilli drejtues dhe drejtuesit e lartë ekzekutivë duhet të mbikëqyrin zhvillimin dhe mirëmbajtjen e vazhdueshme të infrastrukturës së kontrollit të cilësisë, që mbron në mënyrë të mjaftueshme sistemet dhe të dhënat e *e-banking* nga kërcënimet e jashtme dhe të brendshme. Ky proces përfshin dhënien e të drejtave të autorizuar, të drejtave për kontrollet logjike dhe fizike, si edhe përcaktimin e sigurisë së mjaftueshme të infrastrukturës për të ruajtur kufijtë dhe kufizimet e duhura në veprimtaritë e brendshme dhe të jashtme.

Këshilli drejtues dhe drejtuesit e lartë ekzekutivë duhet:

b) të përcaktojnë përgjegjësitë eksplicite të personelit për zbatimin dhe kontrollin e zbatimit të politikave të sigurisë së bankës;

c) të mundësojnë kryerjen e kontrolleve të mjaftueshme fizike për t'u mbrojtur nga hyrjet fizike të paautorizuara në ambientin kompjuterik;

d) të mundësojnë kryerjen e kontrolleve të mjaftueshme logjike dhe të proceseve monitoruese për t'u mbrojtur nga hyrjet e jashtme apo të brendshme të paautorizuara në aplikimet dhe në bazën e të dhënave të *e-banking*;

e) të mundësojë kryerjen e rishikimeve të rregullta dhe të testimeve të masave dhe të kontrolleve të sigurisë, duke përfshirë ndjekjen e vazhdueshme të zhvillimeve aktuale të industrisë së sigurisë dhe instalimin e *software*-ve të përmirësuar, të paketave të shërbimit dhe të masave të tjera.

Neni 12

Mbikëqyrja e burimeve të jashtme

Këshilli drejtues dhe drejtuesit e lartë ekzekutivë duhet të vendosin një proces mbikëqyrjeje dhe të zbatojnë kujdes të plotë dhe të vazhdueshëm për administrimin e marrëdhënieve të bankës me palët e tjera të jashtme që mbështesin *e-banking* dhe për përdorimin e burimeve të tjera të jashtme në këtë fushë.

Këshilli drejtues dhe drejtuesit e lartë ekzekutivë duhet të sigurohen që:

a) banka kupton plotësisht rreziqet që shoqërohen me përfshirjen në një marrëveshje partneriteti apo burimi të jashtëm (p.sh. me një kompani të pavarur që ofron shërbimin e internetit etj.) për sistemet dhe aplikimet e saj të *e-banking*;

b) është kryer një rishikim i kujdesshëm dhe i përshtatshëm i aftësisë profesionale dhe i mundësisë financiare të dhënësit të shërbimit si palë e tretë, para nënshkrimit të kontratës për shërbimet e *e-banking*;

c) është përcaktuar qartë përgjegjësia kontraktuale e të gjitha palëve në marrëdhënien e partneritetit, duke përfshirë edhe një palë të jashtme. Veçanërisht, përgjegjësitë për dhënien dhe

marrjen e informacionit tek dhe nga dhënësi i shërbimit, përgjegjësitë për mbajtjen e backup-ve dhe të kopjeve të transaksioneve të kryera nëpërmjet *e-banking*, duhet të përcaktohen qartë;

d) të gjitha sistemet dhe operacionet e *e-banking* të dhëna nga burime të jashtme janë subjekt i administrimit të rrezikut, të politikave të sigurisë dhe të ruajtjes së fshehtësisë që përputhen me standardet e vet bankës;

e) janë kryer kontrolle periodike të brendshme dhe/ose të jashtme ndaj operacioneve të burimeve të jashtme, të paktën në të njëjtën shtrirje që kërkohej kur këto të jenë kryer nga burimet e brendshme;

f) ekzistojnë plane për burime rezervë në raste incidentesh për aktivitetet e *e-banking* nga burimet e jashtme.

Neni 13

Identiteti dhe autorizimi i klientëve

Bankat duhet të marrin masat e nevojshme për të vërtetuar identitetin dhe autorizimin e klientëve me të cilët ato kryejnë biznes nëpërmjet internetit.

a) Bankat duhet të përdorin metoda të sigurta për verifikimin e identitetit dhe autorizimin e klientëve të rinj, si edhe vërtetimin e identitetit të klientëve ekzistues që kërkojnë të ndërmarrin transaksione elektronike.

b) Bankat mund të përdorin metoda të ndryshme, në mënyrë të veçantë ose të kombinuara mes tyre, për të vendosur identifikimin, përfshirë PIN-et, *password*-et, *smart cards*, *biometrics* dhe certifikatat dixhitale. Bankat duhet të monitorojnë dhe adoptojnë praktikatat e shëndosha të industrisë në këtë fushë për të siguruar që:

i) bazat e të dhënave për verifikim, që sigurojnë hyrjen në llogaritë *e-banking* të klientëve ose hyrjen në sistemet sensitive, janë të mbrojtura nga manipulimet dhe korrupsioni; Këto manipulime duhet të jenë të zbulueshme dhe duhet të vendosen kontrolle gjurmimi për të dokumentuar përpjekje të tilla.

ii) shtesat, fshirjet ose ndryshimet për individin, për agjentin ose për sistemin në bazën e të dhënave të verifikimit, janë të autorizuar vetëm nga një burim i verifikuar;

iii) janë vendosur masat e duhura për të kontrolluar lidhjet e sistemit të *e-banking*, me qëllim që palë të treta të panjohura të mos kenë mundësi të zhvendosin ose të zëvendësojnë klientët e njohur.

iv) sesionet e verifikuara të *e-banking* të mbeten të sigurta gjatë gjithë zgjatjes së seancës ose në rast të një gabimi sigurie, sistemi kërkon riverifikimin.

Neni 14

Verifikimi i transaksioneve

Bankat duhet të përdorin metoda të verifikimit të transaksionit, të cilat nxisin njohjen reale të fakteve dhe vendosin përgjegjësitë për transaksionet e *e-banking*.

Bankat duhet të bëjnë përpjekje të arsyeshme, në përputhje me tipin e transaksionit *e-banking* dhe vlerën që ai ka ose mund të ketë për bankën, për t'u siguruar që:

a) sistemet e *e-banking* janë projektuar për të reduktuar mundësinë që përdoruesit e autorizuar do të ndërmarrin transaksione të pamenduara dhe që klientët i kuptojnë plotësisht rreziqet që lidhen me transaksionet që ata ndërmarrin;

b) të gjitha palët në transaksion janë të verifikuara pozitivisht dhe është kryer kontrolli për kanalet e verifikimit;

c) të dhënat e transaksioneve financiare janë të mbrojtura nga modifikimet dhe nëse ndodhin, këto modifikime të jenë të kapshme.

Neni 15

Ndarja e detyrave

Bankat duhet të sigurojnë që janë vendosur masat e përshtatshme për ndarjen e duhur të detyrave brenda sistemeve, bazave të të dhënave dhe aplikimeve të *e-banking*.

Praktikat për vendosjen dhe për ruajtjen e ndarjes së detyrave brenda ambientit të *e-banking* përfshijnë:

- a) proceset dhe sistemet, të cilat sigurojnë që asnjë punonjës/dhënës i shërbimit nga jashtë të mund të hyjë, të autorizojë dhe të plotësojë një transaksion;
- b) ndarjen e detyrave midis atyre që organizojnë të dhënat statike (përfshirë përmbajtjen e faqes së *web-it*) dhe atyre që janë përgjegjës për verifikimin e integritetit të tyre;
- c) testimin e sistemeve *e-banking* duke siguruar që ndarja e detyrave nuk mund të kapërcehet ose të anashkalohet;
- d) ndarjen e detyrave midis atyre që zhvillojnë dhe atyre që administrojnë sistemet e *e-banking*.

Neni 16

Kontrolli dhe e drejta e hyrjes në sistem

Bankat duhet të sigurojnë që janë vendosur kontrollet për autorizimet dhe privilegjet për të drejtat e hyrjes në sisteme, në bazën e të dhënave dhe aplikimet e *e-banking*.

Me qëllim që të ruajnë ndarjen e detyrave, bankat duhet të kontrollojnë në mënyrë strikte privilegjet e autorizimit dhe të hyrjes. Në sistemet e *e-banking*, autorizimet dhe të drejtat për hyrje mund të vendosen në mënyrë të centralizuar ose të shpërndarë brenda një banke dhe në përgjithësi janë të ruajtura në bazat e të dhënave. Mbrojtja e këtyre bazave të të dhënave nga ndërhyrja e të tjerëve apo korrupsioni, është themelore për kontrollin e autorizuar dhe efektiv.

Neni 17

Mbrojtja e integritetit

Bankat duhet të sigurojnë që janë vendosur masat e duhura për të mbrojtur integritetin e të dhënave të transaksioneve, të regjistrimeve dhe të informacioneve të *e-banking*.

a) Bankat duhet të sigurojnë që janë vendosur masat e përshtatshme për të përcaktuar saktësinë, plotësinë dhe sigurinë e transaksioneve, të regjistrimeve dhe të informacionit të *e-banking* që transmetohet nëpërmjet internetit, rezident në bazën e brendshme të të dhënave të bankës, ose që transmetohet/ruhet nga një dhënës shërbimi i tretë në emër të bankës.

b) Praktikat për ruajtjen e integritetit të të dhënave brenda ambientit të *e-banking* përfshijnë:

- i) kryerjen e transaksioneve të *e-banking* në një mënyrë që i bën ato shumë rezistente ndaj ndërhyrjeve gjatë gjithë procesit;
- ii) ruajtjen, aksesimin dhe modifikimin e regjistrimeve të *e-banking*, në një mënyrë që i bën ato shumë rezistente ndaj ndërhyrjeve;
- ii) projektimin e transaksioneve të *e-banking* dhe të proceseve të mbajtjes së regjistrimeve, në një mënyrë që e bën të pamundur shmangien e zbulimit të ndryshimeve të paautorizuara;
- iii) vendosjen e politikave të mjaftueshme të kontrollit të ndryshimeve, duke përfshirë procedurat e monitorimit dhe të testimit, që vendosen për t'u mbrojtur kundër ndryshimeve të sistemit të *e-banking* dhe që mund të kompromentojnë gabimisht kontrollet ose sigurinë e të dhënave;
- iv) zbulimin e ndërhyrjeve në transaksionet ose në regjistrimet e *e-banking* nëpërmjet procesimit të transaksionit, të funksioneve të monitorimit dhe të mbajtjes së regjistrimeve.

Neni 18

Kontrolli i transaksioneve e-banking

Bankat duhet të sigurohen që ekzistojnë kontrolle të sigurta për të gjitha transaksionet e *e-banking*.

Shpërndarja e shërbimeve financiare nëpërmjet internetit mund ta bëjë më të vështirë për bankat që të aplikojnë dhe të vënë në zbatim kontrollet e brendshme dhe të mbajnë gjurmimin e sigurtë të kontrollit, nëse këto masa nuk janë përshtatur për një mjedis *e-banking*. Në procesin e përcaktimit se ku duhet të kryhen gjurmimet e kontrollit, duhet të merren në konsideratë elementët e

mëposhtëm të transaksioneve të *e-banking*:

- a) hapja, modifikimi ose mbyllja e llogarisë së klientit;
- b) pasojat financiare të transaksionit;
- c) një autorizim i dhënë një klienti që kalon kufirin e lejuar;
- d) një dhënie, një ndryshim ose një revokim i të drejtave dhe i privilegjeve për hyrjen në sisteme.

Neni 19

Ruajtja e informacionit

Bankat duhet të marrin masat e duhura për të ruajtur konfidencialitetin e informacionit themelor të *e-banking*. Masat e marra për ruajtjen e konfidencialitetit duhet të jenë në përpjesëtim me ndjeshmërinë e informacionit që transmetohet dhe/ose ruhet në bazën e të dhënave.

Për këtë bankat duhet të sigurohen që:

- a) të gjitha të dhënat dhe regjistrimet konfidenciale të bankës të jenë të arritshme vetëm nga individë, nga agjentë dhe nga sisteme të autorizuar dhe të vërtetuara;
- b) të gjitha të dhënat konfidenciale të bankës të ruhen në mënyrë të sigurtë dhe të mbrohen nga shikimi ose nga ndryshimi, gjatë transmetimit nëpërmjet rrjeteve publike, private ose të brendshme;
- c) standardet dhe kontrollet e bankës për përdorimin dhe për mbrojtjen e të dhënave të zbatohen edhe kur palët e treta kanë akses të të dhënave nëpërmjet marrëdhënieve të burimit të jashtëm;
- d) të gjitha hyrjet të të dhënave të kufizuara të jenë të gjurmueshme dhe të kërkojnë konfirmim (të jenë të loguara), edhe pas një numri të caktuar përpjekjesh jo të suksesshme për t'u loguar.

Neni 20

Informimi i klientëve

Bankat duhet të sigurohen që është dhënë informacioni i mjaftueshëm në *website*, për t'iu lejuar klientëve që të kenë një konkluzion të informuar mbi identitetin e bankës dhe statusin rregullator të saj, para se të hyjnë në transaksionet e *e-banking*.

Informacionet që banka duhet të sigurojë në *website*-in e saj janë:

- a) emri i bankës dhe vendndodhja e zyrës qendrore të saj (dhe e zyrave lokale, në qoftë se është e aplikueshme);
- b) identiteti i autoritetit kryesor mbikëqyrës bankar, i cili është përgjegjës për mbikëqyrjen e zyrës qendrore të bankës;
- c) mënyra si mund të kontaktojnë klientët me qendrën e shërbimit të klientit të bankës në lidhje me problemet e shërbimit, me ankesat, me keqpërdorimin e dyshimtë të llogarive etj.;
- d) si mund të kenë klientët akses për informacionin mbi kompensimin e aplikueshëm, mbulimin e depozitave të siguruara dhe nivelin e mbrojtjes që këta përballojnë (ose lidhjet në *website*-et që japin një informacion të tillë);
- e) informacione të tjera që mund të jenë të përshtatshme ose që kërkohen nga situata të veçanta.

Neni 21

Kërkesa në lidhje me fshehtësinë e klientit

Bankat duhet të marrin masat e duhura për të siguruar besnikërinë ndaj kërkesave të fshehtësisë për klientin, të aplikueshme në juridiksionet në të cilat banka ofron produktet dhe shërbimet e *e-banking*.

Bankat duhet të bëjnë përpjekje të arsyeshme për t'iu siguruar që:

- a) politikat dhe standardet e fshehtësisë së klientit të bankës marrin parasysh përputhshmërinë

me të gjitha ligjet dhe rregulloret për fshehtësinë, në juridiksionin në të cilin ajo ofron produktet dhe shërbimet e *e-banking*;

b) klientët janë njohur me politikat dhe me çështjet që lidhen me fshehtësinë në lidhje me përdorimin e produkteve dhe të shërbimeve të *e-banking*;

c) klientët mund të heqin dorë nga lejimi i bankës që të ndajë me palë të treta për qëllime *cross-marketing* informacionin mbi kërkesat, mbi interesat, mbi pozitën financiare ose veprimtarinë bankare personale të klientit;

d) të dhënat për klientin nuk përdoren për qëllime të tjera, përveç atyre që janë lejuar specifikisht ose të cilat janë lejuar prej klientit;

e) standardet e bankës për përdorimin e të dhënave të klientëve duhet të zbatohen edhe kur palët e treta kanë akses në të dhënat e klientit nëpërmjet marrëdhënieve me burime të jashtme.

Neni 22

Sigurimi i vazhdimësisë së aktiviteteve e-banking

Bankat duhet të kenë kapacitete efektive, të sigurojnë vazhdimësi të biznesit dhe procese efektive të planifikimit të rezervave, për të ndihmuar në sigurimin e disponueshmërisë së sistemeve dhe të shërbimeve të *e-banking*.

a) Për të mbrojtur bankat kundrejt rrezikut të biznesit, rrezikut ligjor dhe atij reputacional, shërbimet e *e-banking* duhet të kryhen në mënyrë të vazhdueshme dhe t'i përgjigjen në kohë pritjeve të klientit;

b) Për të arritur këtë, banka duhet të ketë aftësinë të japë shërbimet *e-banking* te përdoruesit e fundit, si nga burimet parësore (si: sistemet dhe aplikimet e brendshme të bankës), ashtu edhe nga ato dytësore (si: sistemet dhe aplikimet e ofruesve të shërbimit).

Për t'iu ofruar klientëve vazhdimësinë e shërbimeve të *e-banking* që ata presin, bankat duhet të sigurohen që:

d) kapacitetet aktuale dhe zhvillimi i ardhshëm i sistemeve të *e-banking* janë analizuar në kuadër të zhvillimit të të gjitha tregjeve për tregtinë elektronike dhe të shkallës së pritshme të pranimin nga klienti të produkteve dhe të shërbimeve *e-banking*;

e) llogaritjet e kapacitetit të procesimit të transaksioneve të *e-banking* janë vërtetuar, janë testuar (*stress tested*) dhe janë rishikuar periodikisht;

f) planet për vazhdimësinë e veprimtarisë normale për sistemet dhe procesimet kritike të *e-banking* janë në fuqi dhe të testuara rregullisht.

Neni 23

Administrimi i ngjarjeve të papritura

Bankat duhet të kenë plane të përshtatshme në përgjigje të incidenteve, për të administruar, për të mbajtur dhe për të minimizuar problemet që dalin nga ngjarjet e papritura (duke përfshirë goditjet e brendshme dhe të jashtme), që mund të vështirësojnë ofrimin e sistemeve dhe të shërbimeve të *e-banking*.

Për të siguruar një reagim efektiv ndaj ngjarjeve të parashikuara, bankat duhet të përgatisin:

a) planet e reagimit ndaj ngjarjeve të parashikuara, për të adresuar rivendosjen në punë të sistemeve dhe të shërbimeve të *e-banking*. Analiza e skenarëve duhet të marrë në konsideratë mundësinë e ndodhjes së rrezikut dhe ndikimin e tij te banka. Sistemet e *e-banking* që shërbejnë nga ofrues të jashtëm, duhet të jenë pjesë integrale e këtyre planeve;

b) mekanizmat për të identifikuar një incident apo një krizë sapo të ndodhë, për të vlerësuar materialitetin e tyre dhe për të kontrolluar rrezikun e reputacionit që lidhet me ndonjë ndërprerje në shërbim;

c) një strategji komunikimi për të adresuar mjaftueshmërisht shqetësimet e tregjeve të jashtme dhe të mjeteve të komunikimit, që mund të dalin në rast të dështimeve të sistemeve të *e-banking*;

d) një proces të qartë për njoftimin e autoriteteve mbikëqyrëse, në rastet e thyerjeve materiale të sigurisë ose të ndodhjes së incidenteve të ndërprerjeve;

e) skuadrat e reagimit ndaj incidenteve, të cilat duhet të jenë të trajnuara në mënyrë të mjaftueshme dhe të kenë autoritetin për të vepruar në emergjencë, për të analizuar sistemet e

reagimit/zbulimit të incidenteve dhe për të interpretuar domethënien e rezultatit;

f) një zinxhir të qartë komandash, që përfshin si operacionet e brendshme, ashtu edhe ato nga burimet e jashtme, për t'u siguruar që janë marrë veprimet e menjëhershme sipas rëndësisë së incidentit. Shkallëzimi dhe procedurat e komunikimit të brendshëm duhet të përcaktohen dhe të përfshijnë njoftimin e këshillit drejtues kur është e nevojshme;

g) një proces që të sigurojë që të gjitha palët relevante të jashtme, duke përfshirë klientët e bankës, korrespondentët dhe mjetet e komunikimit janë informuar në kohë dhe në mënyrën e duhur për ndërprerjet e *e-banking* dhe zhvillimet e rifillimit të veprimtarisë;

h) një proces për grumbullimin dhe ruajtjen e evidencës së ligjshme për të lehtësuar rishikimet e nevojshme pas ndodhjes të ndonjë incidenti të *e-banking*, si edhe për të ndihmuar në ngritjen e akuzës ndaj ndërhyrësve të paligjshëm.

Neni 24 **Penalizimet**

Mosrespektimi i kërkesave të kësaj rregulloreje përbën shkelje të kushteve për kryerjen e veprimtarisë bankare në mënyrë të shëndoshë dhe të sigurtë dhe trajtohet sipas përcaktimeve të nenit 44 të ligjit nr.8365, datë 2.7.1998 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”.

Neni 25 **Kalimtare**

Bankat që kanë filluar kryerjen e transaksioneve *e-banking* para hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, duhet që brenda një periudhe gjashtëmujore nga hyrja në fuqi e saj, të plotësojnë kushtet e parashikuara në këtë rregullore.

Neni 26 **Hyrja në fuqi**

Kjo rregullore hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë

KRYETARI I KËSHILLIT MBIKËQYRËS
Ardian Fullani

VENDIM **Nr.327, datë 29.3.2005**

MBI LICENCËN PËR TV VENDOR PRIVAT “SKAMPA”

Në mbështetje të nenit 7 pika 21, nenit 22 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, si dhe të vendimit të KKRT-së nr.255, datë 31.8.2004 “Mbi vlefshmërinë e licencës së TV Skampa”, Këshilli Kombëtar i Radios dhe i Televizionit

VENDOSI:

1. T'i heqë subjektit fizik, z.Genti Ceka licencën për televizionin vendor TV Skampa.
2. Licenca nr.027/TVL bëhet e pavlefshme.
3. T'i japë subjektit, shoqërisë “TV Skampa” sh.p.k., me vendndodhje në qytetin e Elbasanit, licencë, duke e autorizuar të funksionojë si operator televiziv vendor privat, në fushën e transmetimeve tokësore analogjike për një periudhë prej 5 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj

licence.

4. Licenca bashkëlidhur, përmban kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zonat e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.

5. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Halil Lalaj

VENDIM
Nr.328, datë 29.3.2005

PËR DHËNIE LICENCE
PËR TRANSMETIM TË PROGRAMEVE TË HUAJA RADIO NË SHQIPËRI “RFI”

SUBJEKTIT: AMBASADA FRANCEZE
(PËRFAQËSUAR NGA ZNJ.CATHERINE KHOUSSIAINOV)

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë” dhe të “Rregullores për licencimin e operatorëve për ritransmetimin e programeve të huaja televizive dhe radio me përsëritës”, miratuar me vendimin nr.26, datë 23.10.2000 të KKRT-së, Këshilli Kombëtar i Radios dhe i Televizionit

VENDOSI:

1. T’i japë Ambasadës Franceze në Tiranë licencë, duke e autorizuar të funksionojë si operator për ritransmetimin e programeve të huaja radio me përsëritës RFI, për një periudhë prej 4 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence.

2. Licenca bashkëlidhur, përmban kushtet e licencës, ku përfshihen zonat e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.

3. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Halil Lalaj

VENDIM
Nr.329, datë 29.3.2005

PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT TELEVIZIV VENDOR “TV KUKËSI”

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, “Rregullores mbi procedurat e rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, si dhe të kërkesës së subjektit të interesuar, si dhe të kërkesës së subjektit televiziv vendor Kukësi, Këshilli Kombëtar i Radios dhe i Televizionit

VENDOSI:

1. Në mbarim të afatit të licencimit, sipas licencës nr.041/TVL, të rinovojë për një afat të ri 5-vjeçar në fushën e transmetimeve tokësore analogjike, subjektin “Televizioni Kukësi”, sh.a. për televizionin “TV Kukësi”.
2. Subjekti detyrohet të shlyejë detyrimet financiare të prapambetura brenda datës 30.6.2005.
3. Për mosrespektim të afatit, sipas pikës 2 të këtij vendimi, KKRT do të shpallë pavlefshmërinë e licencës, sipas nenit 33 pikës 5 të ligjit.
4. Kushtet e licencës, sipas pikës 1 të këtij vendimi, mbeten të pandryshuara.
5. Ky vendim hyn në fuqi në datën 3.1.2005 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Halil Lalaj

VENDIM
Nr.330, datë 29.3.2005

PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT TELEVIZIV VENDOR “TV ATN 1”

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, “Rregullores mbi procedurat e rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, si dhe të kërkesës së subjektit të interesuar, si dhe të kërkesës së subjektit televiziv vendor ATN 1, Këshilli Kombëtar i Radios dhe i Televizionit

VENDOSI:

1. Në mbarim të afatit të licencimit sipas licencës nr.043/TVL, të rinovojë për një afat të ri 5-vjeçar në fushën e transmetimeve tokësore analogjike subjektin “Media Sat” sh.a. për televizionin “ATN 1”.
2. Subjekti detyrohet të shlyejë detyrimet financiare të prapambetura brenda datës 30.6.2005.
3. Për mosrespektim të afatit, sipas pikës 2 të këtij vendimi, KKRT do të shpallë pavlefshmërinë e licencës, sipas nenit 33, pikës 5 të ligjit.
4. Kushtet e licencës, sipas pikës 1 të këtij vendimi, mbeten të pandryshuara.
5. Ky vendim hyn në fuqi në datën 3.1.2005 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Halil Lalaj

SHPLLJE KËRKESE PËR SHPRONËSIM

Ministria e Industrisë dhe e Energjetikës shpall kërkesën për shpronësim me interes publik të pasurisë së paluajtshme të tipit “tokë bujqësore arë”, që preket nga ndërtimi i nënstacionit 110/20 Porto-Romano, Durrës.

Subjekti kërkuar i këtij shpronësimi është KESH sh.a. Tiranë.

Me anën e këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personin që preket nga ky shpronësim.

Vënia në dijeni konsiston në sipërfaqen e pasurisë që shpronësohet dhe masën e kompensimit përkatës të llogaritur nga komisioni i posaçëm i shpronësimit pranë Ministrisë së Industrisë dhe të Energjetikës për pronarin sipas listës emërore të mëposhtme.

LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN PËR EFEKT TË NDËRTIMIT TË
NËNSTACIONIT 110/20 KV PORTO-ROMANO-DURRËS

Rrethi: Durrës
Komuna: Spitalë

Lloji i pasurisë së paluajtshme që shpronësohet: Tokë bujqësore arë

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Lloji i pasurisë	Zona kadastrale	Nr. pasurisë	Sip.përgj. që shpronësohet	Çmimi lekë/m ²	Vlera e kompesimit në lekë
1.	Feti	Jusuf	Istrefi	Tokë arë	8517	98/6	4875	1700	8 287 500
	Totali								8 287 500

Fletorja Zyrtare gjendet:

Duke u abonuar për çdo vit pranë:

- çdo njësie postare të qyteteve;
 - Qendrës së Publikimeve Zyrtare;
- Bulevardi Zhan d'Ark, pranë ish-ekspozitës "Shqipëria Sot".
Tel: 04 2555 63; 04 267 468

Për çdo lloj informacioni shihni faqen e internetit në adresën:

www.legjislacionishqiptar.gov.al

Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare mund të gjeni:

BOTIMET:

1. KUSHTETUTA (edhe anglisht)
2. KODI I PROCEDURËS CIVILE
3. KODI I PROCEDURËS PENALE
4. KODI PENAL
5. KODI I PUNËS
6. KODI I FAMILJES
7. KODI CIVIL
8. KODI RRUGOR DHE LIGJ PËR TRANSPORTIN
9. KODI ZGJEDHOR (i azhurnuar)
10. KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE
11. DISPOZITA ZBATUESE TË KODIT RRUGOR

PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI

1. PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PËRMBARIMIT
2. PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PROKURIMIT PUBLIK
3. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR NËPUNËSIN CIVIL
4. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR SISTEMIN E DREJTËSISË
5. PËRMBLEDHJE NË FUSHËN E TAKSAVE DHE TATIMEVE

DOLI NGA SHTYPI

TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT SHQIPTAR 1990-KORRIK 2004

TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT SHQIPTAR 1990-KORRIK 2004

Doli nga shtypi më 13.4.2005

Tirazhi: 4300 copë	Formati: 60x88/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2005

Çmimi 150 lekë